



RAPORTI

I

KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT  
PËR VEPRIMTARINË E ZHVILLUAR

GJATË VITIT 2009

Mars, 2010

## PERMBAJTJA

I.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM .....	4
II.	RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR .....	7
2.1	Kuadri ligjor.....	7
2.2.	Licencimi dhe ecuria e operatorëve të licencuar.....	9
2.3.	Sanksionet ndaj subjekteve .....	16
2.4.	Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së.....	17
2.5.	Çështjet gjyqësore.....	19
2.6.	Respektimi i të drejtave të transmetimit .....	19
III.	PROGRAMACIONI.....	26
3.1	Situata programore në median elektronike .....	26
3.2	Përmbajtja e programeve dhe çështje të etikës .....	28
3.3	Mbrojtja e fëmijëve në programet radiotelevizive.....	30
3.4	Veçori të programacionit në Radiotelevizionin Publik.....	32
3.5	Monitorimi .....	33
3.5.1.	Raportet kohore për subjektet politike.....	33
3.5.2.	Raportet kohore për aktorët “sinkron”.....	35
3.5.3.	Raportet kohore për gjininë .....	36
3.5.4.	Raportet kohore për temën e lajmit.....	36
3.5.5.	Dukuri të veçanta për operatorët radiotelevizivë lokalë. ....	37
3.5.6.	Pasqyrimi i fushatës zgjedhore - Qershor 2009 .....	38
3.5.7.	Mbi zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave. ....	40
IV.	RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT .....	43
4.1.	Planifikimi i rrjeteve numerike .....	43
4.2.	Planifikimi i rrjeteve analoge.....	47
4.2.1.	Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv) për licencimin e operatorëve të rinj, dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.....	47
4.2.2.	Puna për planifikimin e frekuencave analoge televizive për hapjen e vendit për transmetimet numerike .....	50
4.3.	Monitorimi i shfrytëzimit të spektrit të frekuencave .....	51
4.3.1.	Transmetimet e palicencuara (Shfrytëzim i paautorizuar i spektrit):.....	51
4.3.2.	Transmetime numerike në kanalet e licencuara si analoge.....	53
4.3.3.	Rrjete kablore të palicencuar .....	53
4.3.4.	Operatorë vendorë të transmetimeve analoge tokësore që kanë ndërprerë transmetimet.....	54
4.3.5.	Rritje e paautorizuar e fuqisë së transmetimit.....	54
4.4.	Përgatitjet për transmetimet numerike .....	54
4.5.	Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.....	58
4.5.1.	Televizioni publik .....	58
4.5.2.	Operatorët privatë kombëtarë .....	61
4.5.2.1.	Operatori Kombëtar TVA.....	62

## KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

4.5.2.2.	Operatori Kombëtar TV KLAN.....	63
4.5.2.3.	Operatori Kombëtar TV TOP CHANNEL .....	64
4.5.3.	Operatorët privatë vendorë .....	67
4.6.	Transmetimet numerike ekzistuese.....	68
4.6.1.	Digitalb .....	68
4.6.2.	Tring.....	70
4.6.3.	Shijak TV .....	71
4.7.	Analiza e dështimit të licencimit të rrjeteve numerike tokësore privatë kombëtarë.....	74
4.7.1.	Arsyet kryesore të paraqitura nga kandidatët për mosparaqitjen në garë pas regjistrimit.....	74
4.7.2.	Arsyet e identifikuar nga KKRT që vështirësojnë procesin e licencimit.....	75
4.7.2.1.	Diferenca të ndjeshme midis kandidatëve konkurrues .....	75
4.7.2.2.	Kuadri ligjor i pamjaftueshëm .....	76
4.7.2.3.	Standardet teknike të rrjeteve numerike.....	78
4.7.3.	Një alternativë për përsheptimin e implementimit të rrjeteve numerike tokësore .....	79
V.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN .....	81
5.1.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative.....	81
5.2.	Marrëdhëniet me jashtë.....	84
5.3.	Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit .....	85
VI.	BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË .....	88
6.1	Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve .....	88
6.1.1	Realizimi i treguesve financiarë – Të ardhurat .....	89
6.1.2	Realizimi i treguesve financiarë - Shpenzimet .....	92
6.2	Pasqyrat financiare të operatorëve RTV .....	94
6.3.	Realizime të tjera .....	95
6.3.1	Dhurimet .....	95
6.3.2	Gjobat.....	95
6.3.3.	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve .....	96
6.3.4.	Rezultatet dhe rekomandimet e kontrollit të ushtruar nga KLSH.....	96
6.3.5.	Të tjera .....	97
VII.	KONKLUZIONE.....	98
VIII.	ANEKSET .....	100
ANEKSI I	Pasqyra e gjobave .....	100
ANEKSI II	Lista e urdhrave për subjektet debitorë.....	104
ANEKSI III	Çështjet gjyqësore .....	106
ANEKSI IV	Raportet e monitorimit për edicionet informative.....	114
ANEKSI V	Mbulimi me sinjal i zonave të licencimit.....(2 Volume bashkëngjitur)	

## I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2009, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është përpjekur maksimalisht që të realizojë ato angazhime dhe objektiva kryesorë që lidhen drejtpërdrejt me ecurinë e funksionimit të institucionit, zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues, përshpejtimin e reformës ligjore, hartimin e strategjisë së kalimit nga sistemi analog në atë numerik etj.

Zbatimi i angazhimeve dhe rekomandimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, ka pasur prioritetin maksimal nëpërmjet përqendrimit të të gjitha kapaciteteve ekzistuese administrative, teknike dhe financiare, në funksion të çuarjes përpara të reformave në këtë fushë. Kjo, pasi fusha audio-vizuale, si pjesë e kriterëve politike për anëtarësim, konsiderohet si një element shumë i rëndësishëm i Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit. Procesi i reformave në fushën e medias kërkon, domosdoshmërisht, përjasjen me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, përfshirë edhe modalitetet e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (nëntor 2009), do të theksonte se *“Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT) ka avancuar përgatitjet për Strategjinë Kombëtare për Digjitalizimin e Televizioneve. Ligji për radiot dhe televizionet publike dhe private ende nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare... Në lidhje me kapacitetet administrative, nuk raportohet progres për kapacitetet monitoruese të KKRT-së”*.

Në konkluzion të këtyre vlerësimeve, ky raport nënvizonte faktin se *“në përgjithësi, ka pasur pak progres në plotësimin e kuadrit ligjor për mediat. Nevojiten më tepër përpjekje për të përmirësuar klimën e përgjithshme të medias, për të finalizuar strategjinë e digjitalizimit dhe për të miratuar legjislacionin kyç për transmetimet, për dekriminalizimin e shpifjes, për informimin publik dhe për transparencën e pronësisë së mediave...”*

Vlerësimet si dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport kanë shërbyer si orientim për veprimet dhe hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren në të ardhmen, pasi plotësimi në vazhdimësi i të gjitha rekomandimeve të dhëna

dhe angazhimeve të marra, do të bëjnë të mundur përafrimin me standardet e kërkuara nga procesi i integritimit evropian.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka arritur që të hartojë projekt-strategjinë e kalimit nga sistemi analog në atë numerik, nëpërmjet zhvillimit të një procesi të gjerë këshillimi publik me të gjithë aktorët e interesuar, si dhe të propozojë ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ad-hoc për Strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në ato digjitale.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 77, datë 02.06.2009, është ngritur Komiteti Ad-hoc, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore (MPPTT, METE, MF, MTKRS, AKSHI, ASKEP, ZSHDA, AK), përfaqësues të shoqatës së operatorëve radiotelevizivë, të zyrës për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe të Radiotelevizionit Publik Shqiptar. Qëllimi i këtij komiteti është “të vlerësojë propozimet e grupit teknik në përbërje të KKRT-së, për strategjinë më të mirë, për një kalim optimal në transmetimet digjitale në Shqipëri”.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit mendon se duhet të përshpejtohen hapat për miratimin e projektstrategjisë, pasi procesi i kalimit në sistemin numerik është një proces kompleks dhe i vështirë, që kërkon një bashkëpunim ndër-institucional. Duke qenë se ky kalim përfshin një tërësi institucionesh publike (ekzekutive dhe legjislative) dhe grupet e interesit, do të kërkojë marrjen e masave dhe aktiviteteve të vazhdueshme analitike dhe konceptuale. Sa më sipër është e qartë edhe nga eksperiencat dhe praktikatat ndërkombëtare të ndjekura gjatë procesit të kalimit në sistemin numerik.

Fakti që në përputhje me kuadrin e brendshëm legjislativ dhe angazhimet e marra në nivel ndërkombëtar, duhet që brenda vitit 2012 ky proces të përfundojë, është një arsye madhore për nevojën e përshpejtimit të hapave konkretë që duhet të ndërmerren në këtë drejtim.

Raportet dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë i kushtojnë, gjithashtu, një vëmendje të veçantë reformës ligjore në fushën e transmetimeve radiotelevizive, duke kërkuar përshpejtimin dhe përfundimin e saj, brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore.

Kryerja e një reforme të plotë ligjore konsiderohet prioritare për vetë situatat dhe problematikat që ka shfaqur dhe shfaq legjislacioni ekzistues si në raport me standardet dhe praktikatat e njohura ndërkombëtare, ashtu dhe me vetë zhvillimet teknologjike në këtë fushë. Për këtë arsye kjo reformë ligjore duhet të bëhet në këshillim të ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, shoqërinë civile si dhe me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim që të gjitha ndryshimet e propozuara apo të miratuara të jenë në përputhje me standardet evropiane dhe më gjerë.

Nga ana e saj, KKRT ka ofruar dhe do të ofrojë të gjithë eksperiencën dhe ekspertizën që ajo disponon, në lidhje me realizimin me sukses të kësaj reforme. Asistenca e ofruar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, dy institucione ndërkombëtare të konsideruara si “prodhuesit” kryesorë të standardeve evropiane në këtë fushë, konsiderohet një mbështetje e fuqishme në këtë drejtim.

KKRT vlerëson se kuadri i ri ligjor do të duhet të aktivizojë potencialin teknik dhe ekonomik të medias, si një faktor kyç i shoqërisë së informacionit, duhet të liberalizojë më shumë tregun, të promovojë konkurrencën, krijimin e klimës së duhur të investimeve, por njëkohësisht të konservojë rolin tradicional të radios dhe televizionit në aspektin social, kulturor dhe edukues.

Gjatë vitit 2009, një problem ka qenë dorëheqja e Kryetarit të KKRT-së (maj 2009) si dhe dorëheqja e një anëtari të KKRT-së (qershor 2009), gjë që krijoi në momente të caktuara një impas në punën e Këshillit dhe pamundësinë e formimit të kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimeve të caktuara.

Megjithatë, pavarësisht vështirësive të shfaqura dhe problemeve të hasura, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit edhe gjatë vitit raportues, ka miratuar një tërësi aktesh dhe vendimesh, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në fushën e medias dhe në përmirësimin e peizazhit audio-vizual.

Më konkretisht, veprimet e ndërmarra konsistojnë sic do të jepet në këtë Raport.

## II. RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR

### 2.1 Kuadri ligjor

Veprimtaria e KKRT-së ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë fushën e medias audiovizuale.

Ka një periudhë mbi dyvjeçare që është konstatuar nevoja e reformimit të legjislacionit mbi median audiovizuale jo vetëm si pasojë e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri (nenet 102 e 103) dhe angazhimeve të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA, por edhe si pasojë e zhvillimeve teknologjike që evidentojnë mungesat e legjislacionit aktual. Për këtë qëllim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në Kuvend, ka hartuar një projektligj të ri “Për transmetimet me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë”, që synon harmonizimin e legjislacionit të medias audiovizuale me *acquis communitaire* dhe standardet evropiane, por dhe përfshirjen e shërbimeve të reja audiovizuale që legjislacioni i sotëm nuk i parashikon apo rregullon.

Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit 2009, KKRT, brenda kompetencave të veta, ka paraqitur propozimet dhe sugjerimet e saj për projektligjin e ri.

Gjithashtu, në këndvështrimin e kompetencës së KKRT-së për të hartuar akte nënligjore në zbatim të ligjit, është punuar për hartimin apo ndryshimin e rregulloreve, me qëllim që brenda kuadrit ligjor të përmirësohet aktiviteti i KKRT-së dhe të lehtësohet veprimtaria e operatorëve radiotelevizivë.

Gjatë këtij viti, KKRT ka miratuar me vendimin 795, datë 27.03.2009, Rregulloren “Mbi shenjat paralajmëruese për respektimin e normave etiko-morale në programet radiotelevizive”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja e përgjegjësisë së operatorëve radiotelevizivë ndaj zbatimit të kërkesave të ligjit

për respektimin e normave morale dhe etike, veçanërisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në programet radiotelevizive.

KKRT, me vendimin nr. 852, datë 15.05.2009, ka miratuar edhe disa ndryshime në rregulloret e KKRT-së mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radiotelevizivë në nivel vendor dhe kombëtar, duke përputhur këto akte me ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht, nëpërmjet këtij akti është hequr detyrimi i subjekteve që kërkojnë të licencohen për veprimtari radiotelevizive, për të depozituar pranë KKRT-së "Disponibilitetin e frekuencave të lidhjeve pikë më pikë të miratuara nga AKEP". Ky detyrim është hequr edhe për subjektet radiotelevizivë, të cilët në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, kur dëshirojnë të vazhdojnë veprimtarinë radiotelevizive, paraqesin kërkesën për rinovimin e licencës 90 ditë para përfundimit të saj. Gjithashtu, subjektet që aplikojnë për rinovimin e licencës nuk e kanë më detyrimin për të depozituar në bankë 10% të kapitalit të nevojshëm. Ky detyrim është hequr nga KKRT, për arsye se subjekti që aplikon për rinovim licence e ka depozituar garancinë bankare në momentin që është licencuar dhe se parësore për KKRT-në, gjatë procesit të rinovimit të licencave, mbetet detyrimi ligjor i përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, sipas të cilit, gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës, operatori i licencuar duhet të ketë qenë i rregullt në zbatimin e ligjit.

Ndërsa me vendimin nr. 883 datë 13.10.2009 janë miratuar disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizive me kabëll", ku janë shtuar garanci për respektimin e të drejtave të transmetimit nga këta operatorë. Konkretisht, aplikuesit për marrje licence për operator televiziv privat kabllor, tanimë janë të detyruar të depozitojnë marrëveshjet paraprake me shoqëritë distributore, lidhur me programet radiotelevizive që mendojnë të ritransmetojnë në rast se do të licencohen nga KKRT. Nga ana tjetër, operatorët e licencuar nga KKRT për veprimtari radiotelevizive private kabllore janë të detyruar të njoftojnë KKRT-në, për çdo ndryshim në programe gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Operatorët radiotelevizivë privatë kabllorë janë të detyruar të caktojnë vendet e programeve në paketë dhe t'i kenë ato të afishuara në mjediset e tyre.

Në përmbushje të objektivave të veta, KKRT, gjatë vitit 2009, ka realizuar licencimin e tri platformave numerike private satelitore “Digitalb”, “Supersport” dhe “Tring”. Licencimi i operatorëve numerikë është një kërkesë urgjente e kohës, nisur si nga situata aktuale e ekzistencës në treg të operatorëve të tillë, ashtu edhe nga angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë për kalimin në transmetime numerike në vitin 2012. Gjatë vitit 2008, KKRT ndërmoi procedurat e licencimit të operatorëve numerikë tokësorë, duke shpallur konkurrimin publik, por kjo procedurë nuk u arrit të realizohej për mosparaqitje të kandidaturave. KKRT ka evidentuar si shkaqe kryesore për mosrealizimin e këtyre procedurave dhe që efektivisht pengojnë procesin e licencimit, kuadrin ligjor të pamjaftueshëm dhe mungesën e strategjisë së miratuar për zhvillimin e perspektivës së transmetimeve numerike. Për këtë arsye, licencimi i operatorëve numerikë satelitorë në këto kushte vlerësohet si një hap vërtet pozitiv. Nga ana tjetër, kjo nënvizon nevojën urgjente të miratimit të projektligjit të ri të medias audiovizuale dhe strategjisë.

Një punë e konsiderueshme është bërë në përfundim të këtij viti dhe në fillim të vitit 2010 edhe me përgatitjen e pyetësorit të dërguar nga Komisioni i BE, si pjesë e procedurës për aplikimin për statusit e vendit kandidat. Në këtë proces të rëndësishëm dhe historik institucioni i KKRT ka luajtur rolin e vet.

Gjatë vitit 2009, KKRT ka marrë gjithsej 147 Vendime. Këto vendime lidhen kryesisht me shqyrtimin e aplikimeve për licenca apo rilicencime, e kërkesave nga subjekte të ndryshëm, e ankesave për sanksione të vënë ndaj subjekteve në shkelje të ligjit, apo shqyrtimin e çështjeve e problemeve të tjera të sektorit.

### **2.2. Licencimi dhe ecuria e operatorëve të licencuar**

Licencimi i operatorëve radiotelevizivë është një nga funksionet kryesore të KKRT-së, i cili bëhet në bazë të kërkesave të subjekteve, disponibilitetit të frekuencave dhe në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Gjatë vitit 2009, KKRT -ja ka licencuar gjithsej 44 subjekte radiotelevizive ku kryesisht, numrin më të madh e zënë operatorët radiotelevizivë kabllorë.

Licencimet janë si më poshtë:

A. Tri platforma numerike private satelitore, konkretisht:

1. "Digitalb";
2. "Supersport";
3. "Tring".

Theksojmë se KKRT, me licencimin e 3 subjekteve të sipërpërmendur si platforma private numerike satelitore, ka hedhur hapin e parë drejt kalimit në sistemin numerik.

B. Operatorë televizivë privatë analogë vendorë (8 subjekte), operatorë radiofonikë analogë privatë vendorë (14 subjekte) dhe operatorë televizivë privatë kabllorë (20 subjekte), konkretisht si më poshtë vijon:

TV Vendorë

1. TV Vendor "K8" (Qarku Vlorë);
2. TV Vendor "ETV" (Qyteti Elbasan);
3. TV Vendor "Tele 4" (Qarku Berat);
4. TV Vendor "JUG" (Qyteti Fier);
5. TV Vendor "TV 7" (Qyteti Lushnjë);
6. TV Vendor "Glob" (Rrethi Berat);
7. TV Vendor "REX" (Qarku Korçë);
8. TV "Ora" (zgjerim zone qarku Vlorë).

Radio Vendore

1. Radio "Kiss" (Rrethet Tiranë -Durrës);
2. Radio "Ora" (Rrethet Tiranë-Durrës);
3. Radio "Spartak SM" (Qyteti Bilisht);
4. Radio "Jehona" (Rrethi Shkodër);
5. Radio "4" (Qyteti Berat);
6. Radio "JUG" (Qyteti Fier);
7. Radio "Take 5" (Rrethi Tiranë-Durrës);
8. Radio "Lushnja" (Qyteti Lushnjë);
9. Radio "B-94" (zgjerim rrethi Tiranë-Durrës);
10. Radio "1" (Rrethi Tiranë-Durrës);

11. Radio "Scan" (Rrethi Tiranë-Durrës);
12. Radio "Nostalgjia" (Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë);
13. Radio "4+" (Rrethi Lushnjë);
14. Radio "Vlora" (Qyteti Vlorë).

#### TV Kabllorë

1. TV Kabllor "Fraholl" (Komuna Çërravë, Pogradec);
2. TV Kabllor "Flavio Cable" (Rrethi Peshkopi);
3. TV Kabllor "Maqellara" (Komuna Maqellarë);
4. TV Kabllor "Tërbuf" (Komunat Tërbuf-Dushk);
5. TV Kabllor "Dushk" (Komuna Dushk);
6. TV Kabllor "Futura-COM" (Bashkia Vlorë);
7. TV Kabllor "K8" (Bashkia Sarandë, Vlorë, Komunat Farkë, Kashar, Golem);
8. TV Kabllor "Luna" (Kavajë, Komuna Luz i Vogël);
9. TV Kabllor "Jug" (Qyteti Fier);
10. TV Kabllor "Portëz" (Komuna Portëz, Fier);
11. TV Kabllor "Pojan" (Komuna Dermenas, Fier);
12. TV Kabllor "Roskovec" (Komuna Roskovec, Fier);
13. TV Kabllor "Delta" (Komunat Buçimas dhe Hudenisht);
14. TV Kabllor "Hudenisht" (Hudenisht, Pogradec);
15. TV Kabllor "Tata Junior" (Qyteti Bajram Curri);
16. TV Kabllor "Star" (zgjerim zone licencimi në Komunat Farkë, Kashar, Qarku Shkodër, Bashkia Fier);
17. TV Kabllor "Bilishti" (zgjerim zone në Komunat Progër, Hoçisht, Miras);
18. TV Kabllor "Cable Tel" (Qyteti Tiranë);
19. TV Kabllor "Kombi" (zgjerim zone licencimi në qytetin Patos);
20. TV Kabllor "Inkusat" (zgjerim zone licencimi në Komunën Hudenisht).

Gjithashtu gjatë këtij viti janë miratuar dhe një numër i konsiderueshëm kërkesash për rinovim licence (19 subjekte), në mbështetje të ligjit nr. 8410, si dhe në mbështetje e në zbatim të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e KKRT-së "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve radiotelevizivë".

Radiot dhe Televizionet, të cilave, me vendim të KKRT-së, iu është rinovuar licenca, janë si më poshtë vijon:

Rinovim licencash

1. "Radio Logos";
2. "Radio + 2";
3. "Radio Alsat1";
4. "Radio DJ 96.1";
5. "Radio Rock";
6. "Radio Egnatia";
7. "TV Kabllor Lushnja";
8. "TV Kabllor Kombi";
9. "TV Kabllor Inkusat";
10. "TV Alpo";
11. "TV TNSH";
12. "TV Magic";
13. "TV Bilishti";
14. "TV Alsat";
15. "TV Kopliku";
16. "TV Tele 1";
17. "TV 2A";
18. "TV Klan";
19. "TV Alpo";

KKRT, mbështetur në kompetencat e veta, ka marrë edhe vendime për mosdhënie licencash për disa subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në licencë.

Mosdhënie licencash

1. "TV Kabllor Emil Trans 07";
2. "TV Kabllor Nisatel";
3. "TV Vendor Klea";
4. "TV Vendor Star";
5. "Radio Berati";
6. "Radio 108";
7. "Radio Dajçi";
8. "Radio G-Kam";

9. "Radio Koha".

Në përputhje me ligjin 8410 dt. 30.09.1998, i ndryshuar, neni 7 pika 5 vendimet e KKRT për dhënien dhe heqjen e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare. Konstatohet se, gjatë vitit 2009, nuk ka pasur ankesa nga ana e subjekteve të interesuar, lidhur me vendimet e KKRT-së për mosdhënie licence.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009, janë marrë një sërë vendimesh lidhur me miratimin e ndryshimeve në të dhënat e subjekteve të licencuar, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 8410 dt. 30.09.1998, i ndryshuar. Sipas këtij neni, subjektet njoftojnë KKRT për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si: ndryshimet në pronësi, në administrimin apo drejtuesin e shoqërisë, emërtimin e radios ose televizionit, ndryshime në programet që transmeton, selinë apo adresën e subjektit, dhe të tjera kushte që kanë ndryshuar tek subjekti që nga momenti i licencimit. Ky nen i krijon mundësinë që KKRT të kontrollojë përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të licencës nga ana e subjekteve edhe kur ndryshojnë ndonjë nga të dhënat e tyre.

Bazuar në nenin 30 dhe 22 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, ky i fundit parashikon patjetërsueshmërinë e licencës së transmetimit pa miratimin e KKRT-së, bëhet i mundur kontrolli dhe transparenca në pronësinë e licencës. Në këtë mënyrë realizohet roli mbikëqyrës i KKRT-së në kufizimet ligjore të pronësisë, që janë masat që sigurojnë dhe parandalojnë monopolet, koncentrimin dhe promovojnë pluralizmin e medias.

Gjatë vitit 2009, KKRT ka miratuar edhe ndryshimet e të dhënave për 17 subjekte radiotelevizive.

1. Me Vendimin nr. 774, datë 30.01.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Star Eli" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV Kabllor "Star" (kalimi i 100% të aksioneve nga ortakët Ilir Bici dhe Luan Haxhi tek shoqëria "Abcom" sh.p.k. dhe emërimin të z. Edvin Binxhiu administrator të shoqërisë).
2. Me Vendimin nr. 775, datë 30.01.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Club Muzikor" sh.a., licencuar nga KKRT

- për radion private vendore "Club FM" (kalimin e 26% të aksioneve nga ortaku Ioannis Doudoulakis tek Olta Reka dhe ndryshimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë).
3. Me Vendimin nr. 776, datë 30.01.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "AL-TE" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV Kabllor "AL-TE" (kalimi i 100% të aksioneve nga ortakët Arbër Sanxhaku, Pashk Laska, Kristo Ruco dhe Enver Cara me nga 20% të aksioneve secili, tek ortaku Elton Bakalli, njëkohësisht dhe administrator i shoqërisë).
  4. Me Vendimin nr. 777, datë 30.01.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Media 99" sh.a., licencuar nga KKRT për televizionin privat vendor "TV Koha" (kalimin e aksioneve nga ortakët Lefter Koka, Armand Duka, Saimir Mane, Vladimir Kosta, Agron Duka dhe Agim Shenediela me nga 11.11% të aksioneve tek ortaku tjetër i shoqërisë Arben Ismailaga dhe ndryshimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë).
  5. Me Vendimin nr. 781, datë 25.02.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "TV Calvin" në "TV Planet".
  6. Me Vendimin nr. 782, datë 25.02.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "TV Mirdita" në "TV M-PLUS, si dhe ndryshimit të selisë".
  7. Me Vendimin nr. 783, datë 25.02.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "Radio Scorpion" në "Radio Maria".
  8. Me Vendimin nr. 784, datë 25.02.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Onufri" sh.a., licencuar nga KKRT për televizionin privat vendor "TV Onufri" (kalimin e aksioneve nga ortakët Kasem Mahmutaj, Lumir Qosja dhe Damiano Pezzoti tek ortakët Lonik Çuedari, Gledjon Rehovica dhe Petrit Sinaj dhe emërimit të këtij të fundit administrator të shoqërisë).
  9. Me Vendimin nr. 790, datë 27.03.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "TV Egnatia" në "Club TV".
  10. Me Vendimin nr. 811, datë 17.04.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "TV Medisat" në "TV Scan".
  11. Me Vendimin nr. 851, datë 24.04.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "TV Blu" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV Kabllor "Blu" (largimi i ortakut z. Julian Allmeta dhe kalimi i 50% të

- kuotave të kapitalit të tij tek z. Besnik Murrizi, i cili është njëkohësisht dhe administrator i shoqërisë).
12. Me Vendimin nr. 869, datë 12.06.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Tok Media" sh.p.k., licencuar nga KKRT për radion private vendore "Kiss" (kalimi i 80% të aksioneve nga ortaku i vetëm z. Edmond Topi tek ortaku i ri znj. Ajkuna Begeja, e cila është njëkohësisht dhe administrator i shoqërisë, si dhe ndryshimin e selisë së shoqërisë).
  13. Me Vendimin nr. 872, datë 30.07.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Top Channel" sh.a., licencuar nga KKRT për televizionin privat kombëtar "TV Top Channel" (miratimi i ndryshimit të aksionerëve të shoqërisë. Aksionerët e kësaj shoqërie janë z. Aurel Baçi me 20% të aksioneve, znj. Lorela Hoxha me 8% të aksioneve, znj. Vjollca Hoxha me 8% të aksioneve, z. Itan Hoxha me 8% të aksioneve, znj. Sara Hoxha me 8% të aksioneve, z. Albert Sino me 40% të aksioneve dhe znj. Redia Hoxha me 8% të aksioneve).
  14. Me Vendimin nr. 873, datë 30.07.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Top Albania" sh.a., licencuar nga KKRT për radion private kombëtare "Top Albania" (miratimi i ndryshimit të aksionerëve të shoqërisë. Aksionerët e kësaj shoqërie janë znj. Zhuljeta Lamaj me 40% të aksioneve, znj. Zyra Hamiti me 20% të aksioneve dhe znj. Mirela Meraj me 40% të aksioneve).
  15. Me Vendimin nr. 874, datë 30.07.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Trio Tv" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV Kabllor "Trio Cable" (kalimi i 100% të aksioneve tek shoqëria "ABCOM" sh.p.k., z. Nail Jakupi administrator i shoqërisë dhe ndryshimi i emrit të shoqërisë nga "Vëllezërit Jakupi" sh.p.k. në "Trio TV" sh.p.k.).
  16. Me Vendimin nr. 877, datë 13.08.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Albania Byaty" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV vendor "TV Alb-West" (kalimi i 100% të aksioneve nga ortaku i vetëm Franko Muhaxhiri tek znj. Elida Llupa njëkohësisht dhe administratore të shoqërisë, si dhe ndryshimin e emërtimit (logos) të "TV Alb-West" në "Elrodi TV").
  17. Me Vendimin nr. 890, datë 06.11.2009, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Albania Byaty" sh.p.k., licencuar nga KKRT

për TV vendor "Elrodi TV" (ndryshimi strukturës programore dhe bordit drejtues).

Në raport me vitet e shkuara, KKRT vëren një ndërgjegjësime më të madh të operatorëve radiotelevizivë në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga nenet 22 dhe 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

### 2.3. Sanksionet ndaj subjekteve

Një nga detyrat kryesore dhe funksionale të KKRT-së është edhe kontrolli i respektimit të kushteve të licencës. Në bazë të 137/1 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, specialistët e KKRT inspektojnë veprimtarinë e të licencuarit. KKRT ka, gjithashtu, kompetencë të vendosë sanksione nenit 137 për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore (neni 7, pika 11, e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar).

Inspektorët vendosin gjoba dhe, bazuar në nenet 137/4 dhe 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, mund t'i propozojnë Këshillit: reduktimin, pezullimin ose heqjen e licencës së një subjekti. Në zbatim të këtyre dispozitave janë kryer inspektime të shpeshta tek operatorët e licencuar, por gjithashtu janë konstatuar edhe dalje në transmetim të subjekteve të ndryshëm pa licencë. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, ndaj subjekteve kundërvajtës janë ndërmarrë sanksionet përkatëse.

Shkeljet më të prekshme, gjatë vitit 2009 kanë konsistuar në daljen në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së, të operatorëve privatë radiotelevizivë kabllorë, mosrespektimin e të drejtave të transmetimit, mosnjohimin e ndryshimeve të ndodhura te subjektet radiotelevizive etj. Krahas sanksioneve me gjobë, në rastet e daljeve në transmetim pa licencë, janë nxjerrë dhe urdhra që i janë dërguar për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve (shih më poshtë).

Konkretisht, sanksionet me gjobë pasqyrohen në Ankesin 1 të këtij Raporti.

#### 2.4. Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së

Ekzekutimi i vendimeve ndikon drejtpërdrejt në forcimin e autoritetit të KKRT-së. Sipas nenit 137/5 të ligjit nr. 8410, vendimet e KKRT-së për heqjen e licencës, ekzekutimin e sanksioneve me gjobë dhe sekuestrimin realizohen nga Policia Tatimore. Në mbështetje të kësaj baze ligjore, më datë 15.03.2007 është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, marrëveshje e cila i ka specifikuar procedurat e ekzekutimit të vendimeve të KKRT-së.

Pavarësisht sa më sipër, KKRT konstaton se pjesa dërrmuese vendimeve të saj nuk ekzekutohen nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Mosekzekutimi i vendimeve të KKRT-së ka sjellë si pasojë uljen e autoritetit të KKRT-së tek operatorët radiotelevizivë privatë. Neglizhenca e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në mosekzekutimin e vendimeve të KKRT-së konstatohet në Vendimet e KKRT-së për sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjekteve kundërvajtës, pasi janë ezauruar afatet ligjore për bllokimin e tyre. Gjithashtu, kjo neglizhencë konstatohet dhe në ekzekutimin e sanksioneve me gjobë të vendosura nga KKRT. Theksojmë se të ardhurat që merren nga vjelja e gjobave derdhen në buxhetin e shtetit.

Nga inspektimet e realizuara, gjatë vitit 2009, janë identifikuar një numër i konsiderueshëm subjektësh televizivë privatë kabllorë, që kishin dalë në transmetim pa autorizimin e licencimin e KKRT-së. Në mbështetje të neneve 10/a, 137/2 dhe 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe memorandumit të bashkëpunimit të lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, u përpiluan urdhrat për ekzekutim si më poshtë vijon:

- **Urdhri nr. 102, datë 06.11.2009** "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Kozarë të rrethit Kuçovë".
- **Urdhri nr. 103, datë 06.11.2009** "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Pirg të rrethit Korçë".

- Urdhri nr. 104, datë 06.11.2009 "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Rrëmenj të rrethit Pogradec".
- Urdhri nr. 105, datë 06.11.2009 "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Lapardha të rrethit Berat",.
- Urdhri Nr. 106, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Këmishtaj të rrethit Lushnjë".
- Urdhri Nr. 107, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Fier-Shegan të rrethit Lushnjë".
- Urdhri Nr. 108, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Perondi të rrethit Kuçovë".
- Urdhri Nr. 109, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Gegë të rrethit Kuçovë".
- Urdhëri Nr. 110, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Pojan të rrethit Korçë".
- Urdhri Nr. 111, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Sheqeras të rrethit Korçë".
- Urdhëri Nr.112, datë 06.11.2009, "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Kabllor të palicencuar në fshatin Zargoçan të rrethit Pogradec".

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, KKRT, përllorarit, ndjek dhe analizon detyrimet financiare të pagesave për licencë dhe taksat për subjektet e licencuar për të ushtruar veprimtari radiotelevizive. KKRT, në mbështetje të ligjit të sipërcituar, ka të drejtë të bëjë të pavlefshme licencën e subjekteve, në rastet kur këta të fundit nuk shlyejnë detyrimet financiare. Kësisoj, KKRT, gjatë viteve 2000-2009, ka bërë të pavlefshme licencën e disa subjekteve. Për këto subjekte, KKRT ka mbajtur një llogari të veçantë "Debitorë" me shumat përkatëse, sipas llojit të detyrimit (pagesë për licencë apo taksë për shërbimet radiotelevizive) dhe rezulton se, deri më tani, këto subjekte vazhdojnë të jenë "Debitorë".

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 10/a dhe 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur midis KKRT-së dhe DPT-së, kanë dalë urdhrat për 18 subjekte. Deri më tani rezulton se, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nuk është

realizuar ekzekutimi i detyrimeve financiare për këto subjekte (një listë e plotë e këtyre urdhrave jepet në Aneksin 2, bashkëlidhur këtij raportit).

## 2.5. Çështjet gjyqësore

E drejta e ankimit i njihet çdo subjekti që preket nga një vendim i KKRT-së, si nga ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, ashtu dhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Por përveç ankimit administrativ, subjektit i njihet edhe e drejta e ankimit në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Gjatë vitit 2009, KKRT ka qenë palë e paditur në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme, kryesisht me operatorë radiotelevizivë. Në pjesën më të madhe ankimohen në gjykatë vendimet e KKRT-së lidhur me moslicencime, mosrinovime licence, vendosje sanksionesh etj.

KKRT, aktualisht, është e përfshirë në total në 28 procese gjyqësore, nga të cilat 21 janë akoma në proces gjykimi nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Gjykata e Apelit të Vlorës dhe Tiranës dhe në Gjykatën e Lartë. Ndërsa 7 janë çështje të përfunduara (3 janë mbyllur në favor të KKRT-së, 2 kundër dhe 2 pushim gjykimi). Pjesa më e madhe e këtyre çështjeve janë të trashëguara nga vitet paraardhëse, por zgjatja e procedurave gjyqësore ka bërë që gjykimi i tyre të vazhdojë dhe gjatë vitit 2009.

Një pasqyrim në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore, që aktualisht janë në gjykim, jepet në Aneksin 3, bashkëlidhur raportit.

## 2.6. Respektimi i të drejtave të transmetimit

Bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkelje të dispozitave të ligjit për të drejtën e autorit, si dhe për shkelje të të drejtave që lidhen me transmetimet radiotelevizive, "pala e interesuar i

drejtohet gjykatës në përputhje dhe sipas procedurës së përcaktuar në ligjin për të drejtën e autorit". Ky ka qenë rregullimi ligjor për shkeljet e operatorëve radiotelevizivë në fushën e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit. Konfliktet që lindnin midis operatorëve radiotelevizivë në fushën e të drejtave të transmetimit, KKRT i ka parë si konflikt civil midis palëve dhe këto të fundit i ka drejtuar në gjykatë për zgjidhjen e tyre.

Me ligjin nr. 9124, datë 29.07.2003, ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", pësoi amendimin e radhës dhe, ndër të tjera, u shtua neni 40/1, "Detyrimi për depozitimin e dokumentacionit të së drejtës së transmetimeve", sipas të cilit *"Operatorët radiotelevizivë transmetojnë programe të prodhuara nga ata vetë, në bashkëprodhim me të tjerë, me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të identifikojnë, me figurë ose me zë, si dhe të dokumentojnë programet e përcaktuara në paragrafin e parë, duke përcaktuar llojin e programit, realizuesin dhe zotëruesin e pronësisë mbi programin. Operatorët radiotelevizivë të licencuar detyrohen të depozitojnë pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dokumentacionin që vërteton se zotërojnë të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi"*.

Në bazë dhe për zbatim të tij, me Vendimin nr. 165, datë 29.08.2003, KKRT miratoi Rregulloren "Mbi depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit". Bazuar në pikën 3 e vijim të kësaj rregulloreje *"Të gjithë subjektet radiotelevizivë të depozitojnë pranë KKRT-së dokumentacionin e të drejtës së transmetimeve të programeve radiotelevizive, qofshin këto programe të prodhuara vetë, në bashkëprodhim me të tjerë apo me marrëveshje (kontrate shitje, shkëmbimi, dhurimi). Kur është e nevojshme, duhet të depozitohet dhe marrëveshja origjinale nga e cila buron e drejta e shitjes, shkëmbimit apo dhurimit"*. Kopje e kësaj rregulloreje iu dërgua të gjithë subjekteve radiotelevizivë.

Në rast të mos respektimit të kërkesës të mësipërme, KKRT, në mbështetje të pikës 7 të nenit 137/4, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, ka të drejtë të vendosë "Gjobë nga 200.000 deri në 1.000.000 lekë, kur transmetojnë programe që nuk i kanë prodhuar vetë dhe për të cilat nuk kanë marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive,

prodhuesit apo shpërndarësit e autorizuar të tyre. Gjoha vendoset nga KKRT-ja me nismën e saj ose pas ankimit të operatorëve. Përsëritja e kësaj shkeljeje më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50 për qind të afatit të licencës. Në rast ripërsëritjeje shkelja ndëshkohet me heqjen e licencës. Ndëshkimi me gjokat e mësipërme është i vlefshëm edhe për Radio Televizionin Shqiptar”.

Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”, në objektin e tij, ndër të tjera, përfshiu edhe prodhimet audiovizuale dhe kinematografike. Një risi e këtij ligji ishte ngritja dhe funksionimi i Zyrës Shqiptare për të Drejtën Autorit; në kompetencat e saj është zbatimi i dispozitave të Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”.

Në kuadër të rritjes së luftës ndaj piraterisë radiotelevizive, me qëllim eliminimin e saj nga ekranet e operatorëve radiotelevizivë, më datë 28.09.2007 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA). Në mbështetje të pikës 4 të këtij memorandumi, dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontratë shitje, shkëmbimi, dhurimi), duhet të regjistrohet dhe certifikohet më parë në ZSHDA, e më pas të depozitohet në KKRT.

Gjithashtu, në kuadër të luftës ndaj piraterisë radiotelevizive, KKRT ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi edhe me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë. KKRT ka intensifikuar marrëdhëniet me këto institucione për të forcuar bashkëpunimin në monitorimin dhe garantimin e respektimit e të drejtave të autorit. Në kuadër të përpjekjeve për eliminimin e transmetimeve pirate, në bashkëpunim edhe me institucionet e lartpërmendura, ka pasur komunikime me distributorë që operojnë në territorin e Shqipërisë, për të verifikuar burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës apo vërtetësisë dhe legjitimitetit të kontratave.

Pavarësisht sa raportuam më sipër, rezulton se fenomeni “pirateri” në ekranet radiotelevizive mbetet ende i pranishëm, sidomos në operatorët radiotelevizivë kabllorë dhe operatorët radiotelevizivë analogë vendorë, sinjali të cilëve nuk kapet nga studioja e monitorimit në KKRT. Pjesa

dërrmuese e programeve që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë kabllorë janë pa të drejta transmetimi. Aktivitetet sportive ndërkombëtare (Champions League, si dhe kampionatet Seria A, Bundesliga, Premier League, Primeira Divizion etj), janë programe televizive që piratohen më së shumti nga operatorët kabllorë dhe për të cilat subjekte të tjera në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtat e transmetimit të tyre. Pjesa dërrmuese e dokumentacionit të të drejtave të transmetimit (kontratë shitjeje, shkëmbimi, dhurimi), që depozitohet në KKRT nga operatorët radiotelevizivë, nuk janë të regjistruara dhe certifikuar nga ZSHDA.

Të paregjistruara dhe të pacertifikuara nga ZSHDA janë dhe kontratat që operatorët privatë televizivë kabllorë kanë lidhur me ALBAUTOR (shoqatë për mbrojtjen e të drejtave të autorit) e cila pretendon se gëzon të drejtën e nënlicencimit për disa nga kanalet publike ndërkombëtare (ZDF, ARD, RAIUNO, RAIDUE, TVE, etj). Nga analiza e këtyre kontratave nuk del e drejta e kësaj shoqate për të kaluar të drejtat e transmetimit për kanalet e sipërpërmendura. Roli i ZSHDA-së, si institucioni kompetent për mbrojtjen e të drejtave të autorit (në të cilat përfshihet ndër të tjera dhe e drejta e transmetimit) nuk ka qenë në nivelin që ne mendojmë se duhet te jetë. Kjo situatë e ka vënë KKRT-në përpara vështirësive të mëdha, pasi nuk mundemi të saktësojmë (për pjesën më të madhe të programeve), se kush është mbajtësi i vërtetë i të drejtave të transmetimit për programet që transmetohen.

Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, është pjesë thelbësore e garantimit të konkurrencës së ndershme dhe ekuilibrit të tregut mediatik. Respektimi i të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit janë dy çështjet më delikate, që sfidojnë KKRT-në dhe do të vazhdojnë ta sfidojnë edhe në të ardhmen e afërt. Kjo për shkak se pronësia intelektuale është një përvojë e re në Shqipëri, ku mungojnë gjithashtu edhe gjykata të profilizuara edhe juristë të specializuar në këtë fushë. Edhe strategjia e shpallur e KKRT-së në luftë kundër "piraterisë televizive" nuk ka arritur të kthehet në një përvojë të mjaftueshme, sa të sensibilizojë opinionin e operatorëve radiotelevizivë deri në atë shkallë, që masat shtrënguese të mos jenë i vetmi dialog i KKRT-së me ta.

Fakti që ka subjekte radiotelevizivë jashtë juridiksionit ligjor të KKRT-së, ose jashtë kontrollit efektiv të tij në të gjithë territorin, e bën garantimin e të drejtës së autorit ose të pamundur ose sporadik. Nga ana tjetër, pamundësia për të verifikuar burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës së autorit, apo të vërtetësisë dhe origjinalitetit të kontratave, e ka vështirësuar veprimin e KKRT-së në këtë drejtim.

Gjithashtu, pirateria televizive ekziston në një masë më të konsiderueshme të subjektet radiotelevizivë që operojnë në zona të thella, dhe që janë larg mbikëqyrjes e monitorimit të KKRT-së. Monitorimi dhe ndjekja e tyre me sondazhe, sanksionet e ndërmarra dhe publikimi i tyre nuk është i mjaftueshëm për zhdukjen e piraterisë në fushën e transmetimeve radiotelevizive, të të gjithë operatorët radiotelevizivë.

Në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive, KKRT ndërmori një nismë të re në këtë drejtim, duke iu nisur fillimisht të gjithë subjekteve radiotelevizivë shkresat me nr. 802 prot., dhe nr. 803 prot., datë 27.07.2009, lidhur me depozitimin e dokumentacionit në KKRT për të drejtën e transmetimit (sipas detyrimit ligjor të nenit 40/1, i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar). Afati i dorëzimit të këtij dokumentacioni nga ana e subjekteve radiotelevizivë, u la data 30.09.2009, duke iu kujtuar se, në rast të mosrespektimit të ligjit dhe rregulloreve përkatëse do të merren sanksionet e parashikuara në ligj, në rastet kur do konstatohet transmetimi i programeve pirate.

Nga ana tjetër, gjatë muajit shtator, me të gjithë operatorët televizivë kabllorë, u organizuan dy takime informuese në Tiranë dhe në Fier. Atyre iu bë prezent ligji, domosdoshmëria e respektimit të tij, gjendja aktuale dhe masat që do merren nga KKRT me qëllim forcimin e zbatimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të transmetimit.

Pas kësaj, KKRT, prej fundit të shtatorit 2009 dhe në vazhdim, ka organizuar inspektime në terren, në një pjesë të konsiderueshme të territorit ku penetronë subjektet televizivë kabllorë. Gjatë këtyre inspektimeve janë kryer verifikime të një pjesë e konsiderueshme e subjekteve televizive kabllore. Gjithashtu, janë evidentuar edhe shumë subjekte televizive kabllore që ushtronin këtë aktivitet pa licencimin e KKRT-së.

Konstatohet se:

- Shumë prej këtyre televizioneve piratojnë një numër të madh kanalesh.
- Ka ankesa të shumta, nga subjekte mbajtës të të drejtave, për piratim nga këto televizione.
- Ka një numër jo të vogël operatorësh televizivë kabllorë pa licencë, që funksionojnë në qendra të banuara, fshatra, komuna, të cilët ndikojnë negativisht në konkurrencë.

Gjatë vitit 2009 një ndihmë të mirë në fushën e të drejtave të transmetimit dhe të drejtës së autorit ka ofruar Studioja e Monitorimit pranë KKRT-së. Studioja e Monitorimit kryen monitorimin e programeve të subjekteve radiotelevizivë analogë që shihen në Tiranë. Vetë fakti, që valët e këtyre subjekteve radiotelevizivë monitorohen nga KKRT-ja, ka ndikuar në rritjen e përgjegjësisë së operatorëve, sa i ka ulur në minimum rastet e transmetimeve të paligjshme. Por duhet thënë se Studioja e Monitorimit pranë KKRT-së nuk i ka ende mundësitë teknike për ta bërë në shkallë masive një monitorim të tillë. Ende sot, pas rikonstruktimit të saj, mbeten jashtë monitorimit programor të gjithë subjektet radiotelevizive analogë vendorë që nuk shihen në Tiranë; mbeten jashtë platformat numerike tokësore e satelitore, që aktualisht veprojnë në territorin shqiptar; mbeten jashtë të gjithë subjektet televizivë kabllorë, përfshirë edhe ata që veprojnë në Tiranë. Nëse Studioja e Monitorimit pranë KKRT-së do të mundte të kapte sinjalin e të gjithë operatorëve radiotelevizivë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, pra nëse kjo studio do të arrinte të kryente një monitorim të plotë dhe në kohë reale për të gjithë subjektet e licencuar nga KKRT për veprimtari radiotelevizive, kjo do të sillte një ndihmë mjaft të madhe dhe mund të ishte një ndër zgjidhjet në funksion të të drejtave të transmetimit.

Për të përballuar sfidën e mbrojtjes së të drejtave të transmetimit është i nevojshëm hartimi i një strategjie. Kjo strategji duhet të synojë sensibilizimin e të gjithë operatorëve në transmetim, për të respektuar ata vetë ligjet që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale (në përgjithësi) dhe të drejtat e transmetimit (dhe të ritransmetimit) të programeve radiotelevizive (në veçanti).

Strategjia e re e respektimit të ligjshmërisë, që lidhet me pronësinë intelektuale, kërkon edhe ndryshime në legjislacionin që rregullon punën e

KKRT-së. Gjithashtu, nevojë për ndryshime rrënjësore kanë edhe rregulloret e deritanishme, veçanërisht ato që lidhen me dhënien e licencave dhe të dokumentimit të programeve jo prodhime të vetë operatorëve etj.

### III. PROGRAMACIONI

#### 3.1 Situata programore në median elektronike

Viti 2009 shënoi një përmirësim të ndjeshëm të punës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit në fushën e zbatimit të kërkesave të ligjit për programet radiotelevizive. Ky përmirësim i referohet tërësisë së emisioneve që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë, që përfshin strukturën, platformat, tipologjinë e përmbajtjen e tyre në katër drejtime kryesore të përcaktuara në ligj: informativ, edukativ, kulturor artistik e argëtues.

Stadi i sotshëm i zhvillimit të medias elektronike në vendin tonë, rritja e nivelit profesional e teknik të burimeve njerëzore, prurjet cilësore dhe avantazhet e teknologjisë së re dixhitale, diktojnë domosdoshmërisht plotësimin sasior e cilësor të strukturës programore në funksion të përmbajtjes e të respektimit të parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive. Në këtë fushë, KKRT ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë jo vetëm realizimin formal të strukturave programore sipas licencave përkatëse, por edhe zbatimin e ligjshmërisë dhe të standardeve bashkëkohore, si pjesë e rëndësishme e platformave dhe e përmbajtjes cilësore të programeve.

Ndaj dhe metodologjia e përdorur nga KKRT dhe administrata përkatëse në marrëdhëniet me operatorët radiotelevizivë ka ndjekur dy drejtime:

- a. kontrollin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e kërkesave të ligjit dhe zbatimin e strukturave sipas licencave, jo vetëm për operatorët radiotelevizivë kombëtarë, por edhe për ato vendorë, monitorimin e programeve informative dhe reklamave në përputhje me detyrimet ligjore;
- b. veçimin e dukurive dhe problematikave programore që kërkojnë plotësim ose amendim të legjislacionit tonë në këtë fushë.

Për këtë të fundit, gjatë vitit 2009, KKRT ka hartuar e miratuar akte nënligjore sivendime e rregullore, dhe ka paraqitur propozime konkrete për shtesa dhe përmirësime në projekt ligjin e ri "Për transmetimet me zë e figurë në RSH". Propozimet përfshijnë përfundimet e përvojës së punës së institucionit, sintetizimin e përgjithësimin e vërejtjeve e sugjerimeve të qytetarëve, zhvillimin dhe përfshirjen, ose përshtatjen e shtesave në ligjin shqiptar, të orientimeve të AVMSD. (Directive 2007/65/EC of the European Parliament and of the Council of 11 December 2007).

KKRT është përpjekur që përmes komunikimit të vazhdueshëm me operatorët radiotelevizivë këtë metodologji ta vërë në shërbim të ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve të medias. Kjo i ka shërbyer respektimit e ruajtjes së raporteve mes programeve edukative dhe atyre komerciale, mes programeve të blera apo të dhuruara dhe programeve të prodhuara nga vetë operatorët.

Shembulli më i mirë në këtë drejtim mbetet konstatimi se, përgjithësisht, është rritur përgjegjësia e operatorëve me licencë kombëtare për zbatimin e kërkesave të ligjit. Vëmendja dhe intensifikimi i veprimtarisë ligjore, administrative dhe profesionale të KKRT-së gjatë vitit 2009 dëshmon se në fushën e strukturës programore dhe të plotësimit të legjislacionit për median tonë elektronike jemi përpara një problematike të mprehtë. Ajo duhet të përfshijë zhvillimet e deritanishme pozitive, respektimin rigoroz të ligjit e të parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive. Në strukturat programore të operatorëve kombëtarë duhet të gjejnë më shumë hapësirë, emisionet që trajtojnë probleme sociale, si respektimi i të drejtave të grave dhe fëmijëve, programet për përfshirjen dhe integrimin e minoriteteve etnike dhe kulturore, si dhe trajtimi i problematikës së njerëzve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara. Po kaq i rëndësishëm është edhe realizimi i programeve që trajtojnë problematikën e jetës shoqërore, kulturore, gjuhësore të emigrantëve tanë dhe si dhe përmbushja e standardeve mediatike të domosdoshme për proceset e përshtetura integruese që po kalon vendi ynë.

Ashtu si në dy-tre vitet e fundit, edhe gjatë vitit 2009, dukuria e disproporcionit të radiotelevizioneve tematike vijon të dominojë strukturën dhe përmbajtjen programore të transmetuesve të këtij lloji në Shqipëri. Me fjalë të tjera, në Tiranë kemi 4 televizione vetëm informative, 4 televizione

muzikore, një televizion sportiv dhe, së fundmi, ka edhe një televizion tematik vetëm për probleme të ekonomisë. Por nuk kemi ende një televizion analog të posaçëm për fëmijë apo për të rinj. Kjo panoramë bëhet edhe më e diskutueshme, kur televizionet e mësipërme, jo vetëm për nga formati i zgjedhur, kanë fare pak ndryshime nga njëri-tjetri dhe mund të shihen edhe në platformat numerike "Dixhitalb" ose "Tring". Këto raporte nuk pasqyrojnë realitetin e kërkesave të teleshikuesve dhe përftohen prej një konkurrence që kërkon të mbështesë interesa të atypëratyshme komerciale, larg parimeve e kërkesave profesionale e qytetare të veprimtarisë radiotelevizive, veçanërisht mbi misionin etik dhe edukues të saj.

### 3.2 Përmbajtja e programeve dhe çështje të etikës

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së KKRT-së në fushën programore, kanë qenë dhe mbeten monitorimi e vizionimi i përmbajtjes së programeve radiotelevizive, evidentimi e sintetizimi i problematikave, duke kërkuar zbatimin e ligjit dhe respektimin e vlerësimit e normave etike dhe morale, me synime për standarde cilësore.

Nëse në drejtim të strukturave të reja programore, të shumëllojshmërisë ose të paraqitjes së formateve të reja gjatë vitit 2009 nuk mund të flitet për risi e gjetje autentike, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për përmbajtjen e programeve, kompeticionin dhe cilësinë e transmetimit të tyre. Në këtë fushë janë bërë përmirësime të ndjeshme, si në drejtim të përmbajtjes së programeve, të teknologjisë e të cilësisë së transmetimit në funksion të përmbajtjes, ashtu edhe në respektimin e etikës profesionale e qytetare. Por këto përmirësime lidhen më shumë me përpjekje për arritjen e standardeve sesa me vendosjen dhe qëndrueshmërinë e tyre. Vihet re se tendenca e programeve që kanë siguruar audiencë të lartë, luhet midis profesionalizmit të operatorëve radiotelevizivë dhe komercializmit të diktuar jo aq nga nevojat e tregut mediatik, sesa nga interesat e mentaliteti i drejtuesve dhe administratorëve.

Na duhet të konstatojmë sërish, dukurinë e dyndjes së programeve polemizuese me tema kryesisht politike, qoftë brenda të njëjtës strukturë

programore të një operatori radioteleviziv, qoftë si panoramë gati e njëjtë të gjithë operatorët. Në shumicën e mediave tashmë kjo nuk është më tendencë, por një realitet që me sasinë e dendurinë e transmetimit në "orët e pikut" të audiencës, marginalizon llojet e tjera të programeve. Kjo dukuri krijon uniformitet në përmbajtje, shtampon standarde larg profesionalitetit, madje dëmton apo cenon deri edhe lirinë e teleshikuesve, duke u lënë fare pak mundësi zgjedhjeje. KKRT, është e vetëdijshme se përveç ndonjë rasti të largimit nga grilat programore të secilit operator, të miratuara sipas licencave përkatëse, këtu nuk jemi përpara ndonjë shkeljeje ligjore. Nga ana tjetër është po aq e qartë se kemi të bëjmë me një qëndrim e detyrim mirëfilli profesional, etik e qytetar, që duhet të jetë në qendër të vëmendjes së organizmave vetërregulluese të transmetuesve radiotelevizivë, të kodeve të tyre të etikës si dhe të bashkëpunimit të KKRT-së me këto organizma.

Problematika e përmbajtjes së programeve dhe praktika administrative monitoruese e KKRT-së, gjatë vitit 2009, dëshmon se në fushën e përmbajtjes dhe në çështjet e standardeve profesionale dhe etike janë bërë hapa të rëndësishëm përpara. Veçanërisht mediat kombëtare, kanë qenë më të vëmendshme e më të kujdesshme në respektimin e privatësisë së individit, të të drejtave të njeriut, e të çështjeve të etikës në përgjithësi. Por ende janë të pakta programet cilësore për tema të mprehta shoqërore, programet kulturore jo rrallë mbeten në kufijtë e argëtimit, ashtu siç thuhet mungojnë programet specifike për emigrantët tanë në vendet e tjera, programe për personat me aftësi të kufizuar, për minoritete etnike e gjuhësore etj.

Në respektimin e standardeve etike ka ndikuar edhe këmbëngulja e KKRT-së pranë operatorëve radiotelevizivë që ata të hartojnë dhe të miratojnë Kodet e brendshme të etikës, në përputhje me normat morale dhe etike, me synime profesionale të niveleve bashkëkohore. Këto Kode përfshijnë veprimtarinë dhe integritetin e gazetarëve e punonjësve të tjerë të medias si dhe vendosjen e ruajtjen e një niveli qytetar të etikës së komunikimit mediatic. Hartimi i tyre është shenjë e vlerësimit dhe përgjegjësisë ndaj publikut, shijeve e interesave të tij kulturore e gjuhësore. Por, me gjithë arritjet, duhet thënë se kodet e sipërpërmendura në të shumtën e herës janë formale, ende nuk janë kthyer në guida funksionale. Kjo vijon të sjellë në ekran produkte mediatike që nuk respektojnë normat etike, sidomos në programet për fëmijë e të rinj. Raste të tilla ka edhe në pasqyrimin e aksidenteve dhe fatkeqësive, në mbrojtjen e

publikut nga çorientimi, ose në nëpërkëmbjen e rregullave të drejtshqiptimit e të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Në këtë fushë, veprimtaria e Këshillit të Etikës, si një organizëm këshillimor pranë KKRT-së, ka luajtur një rol të vlerësueshëm, në drejtim të trajtimit të vërejtjeve e sugjerimeve të qytetarëve, të ndihmesës në hartimin e rregulloreve apo trajtesave që përfshijnë çështje të etikës e përmbajtjes së programeve, edhe përmes sensibilizimit të opinionit publik. Megjithatë, në situatën kur kërkohet një përgjegjësi më e madhe ndaj përmbajtjes së programeve dhe standardeve etike, KKRT mendon se, së pari, Këshilli i Etikës duhet të funksionojë si një organizëm me kompetenca ligjore e administrative, (Këshilli i Ankesave) siç është parashikuar në projektligjin e ri "Për transmetimet me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë; dhe, së dyti, përmes mekanizmave vetërregullues të transmetuesve e duke njohur e përthithur përvojën e vendeve të Bashkimit Europian. Kodet e Etikës që kanë hartuar një pjesë e operatorëve radiotelevizivë, janë shenjë e rritjes së përgjegjësisë së stafeve drejtuese, ndaj domosdoshmërisë së respektimit të vlerave të deontologjisë së mediave.

### 3.3 Mbrojtja e fëmijëve në programet radiotelevizive.

Grupmosha më e rrezikuar nga programet radiotelevizive që nuk respektojnë kërkesat e ligjit dhe standardet etike janë fëmijët dhe të rinjtë. Ndaj kësaj çështjeje KKRT dhe Këshilli i Etikës, kanë qenë shumë të vëmendshëm dhe kanë kërkuar nga operatorët mbrojtjen e shëndetit moral dhe mendor të fëmijëve, respektimin e të drejtave të tyre, të sanksionuar në legjislacionin tonë dhe në konventat përkatëse, të ratifikuara nga vendi ynë. Por ka edhe çështje të diskutueshme, kryesisht etike dhe estetike që nuk i përfshin korniza e ligjit ekzistues dhe duhet të jenë pjesë e rëndësishme ligjit të ri për median, të shoqëruar me masat dhe sanksionet përkatëse. Problemet që dalin nga përmbajtja e disa lloj programesh, me ose për fëmijë, trajtimi i fëmijëve në programet informative, skenat e këqpërdorimit të dhunës, seksit e gjuhës në disa realizime televizive apo për televizionin janë shqetësuese. Në këtë kontekst, vulgariteti i theksuar, agresiviteti, zhargoni fyes e banal, madje dhe cenimi i dinjitetit të personit a të një grupi shoqëror në disa programe

humoristike, janë thelbi i ankesave të qytetarëve dhe i përfundimeve të sondazheve tona për një numër operatorësh televizivë. Hapi më i rëndësishëm që ndërmori KKRT dhe Këshilli i Etikës në këtë drejtim, gjatë vitit 2009, ishte hartimi, miratimi e dërgimi për zbatim gjithë operatorëve i Rregullores mbi shenjat paralajmëruese në programet radiotelevizive.

Në këtë rregullore përcaktohen kritere të qarta dhe vendosen detyrime për transmetuesit që programet me përmbajtje të papërshtatshme të transmetohen në orare të caktuara, të shoqëruara me shenjën ose shpjegimin përkatës. Më tej KKRT ka ndjekur me vëmendje zbatimin e kësaj rregulloreje dhe mund të thuhet se përmirësimi i bërë në çështjet e etikës dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, që u vërejt më sipër, është ndikuar jo pak prej vlerësimit e zbatimit të saj.

Edhe pse e përsëritur, duhet thënë e vërteta shqetësuese për të gjithë, se programet për fëmijë janë të pakta nga ana sasiore dhe lënë shumë për të dëshiruar nga këndvështrimi i cilësisë. Mungesa e një televizioni të posaçëm për fëmijët që theksuam më lart, nuk përlligj aspak nëpërkëmbjen e detyrimit që kanë transmetuesit, sidomos ata kombëtarë për emisione me karakter edukativ, argëtues, formues e çlodhës që të përfshijnë ose t'ju drejtohen grupmoshave të ndryshme, nga të miturit, fëmijët më të rritur, adoleshentët apo të rinjtë. Përveç disa programeve që veçohen nga të tjerat, si emisionet e fëmijëve në RTSH dhe "Vizion +", konkurset e emisionet muzikore me fëmijë në televizionet "Klan" e "Top Channel", në mjaft programe të tjera për fëmijë, të prodhuara ose të blera, nuk mbahen parasysh kërkesat specifike të moshës. Për hir të audiencës "së sigurt", disa nga këto programe ende nënvleftësohen, janë në nivele amatore, me vlera të dyshimta, jo rrallë edhe nën nivelin e vetë fëmijëve. Veç të tjerash, në emisione të tilla zhvleftësohen kriteret profesionale të gjuhës televizive, nëpërkëmbet gjuha shqipe, kultura dhe etika e komunikimit me fëmijët, qofshin pjesëmarrës apo spektatorë të ekranit. KKRT, ka kërkuar e do të vijojë të kërkojë me rigorozitet zbatimin e ligjshmërisë në platformat programore dhe do të ushtrojë presion e do të bashkëpunojë me organizmat vetërregullues të operatorëve për përmbushjen e standardeve cilësore e etike në programet për fëmijë e të rinj.

Nëse kemi parasysh përhapjen e shërbimeve të reja, të programeve të internetit apo *on line media*, shërbime të cilat fëmijët dhe të rinjtë mund t'i

marrin e t'i ndjekin pa praninë e prindërve e familjarëve më të rritur, atëherë rreziku i dëmtimit të tyre është edhe më i madh. KKRT, edhe pse nuk ka ende asnjë detyrim ligjor për përmbajtjen e këtyre lloj shërbimesh është e gatshme të japë kontributin e vet, qoftë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit, qoftë në sensibilizimin e shoqërisë e të opinionit për përdorimin e tyre nga të rinjtë e adoleshentët.

### 3.4 Veçori të programacionit në Radiotelevizionin Publik

KKRT ndalet në dukuritë e strukturës e të përmbajtjes së programeve të RTSH-së pikërisht prej statusit të tij të veçantë si operator radioteleviziv publik. Detyrimet specifike dhe funksioni i rëndësishëm formues dhe edukativ, i përcaktuar në ligj, kërkojnë një strukturë programore të shumëllojshme. Gama e problematikave të transmetimeve të RTSH-së është e gjerë. Gjatë vitit 2009 ajo përfshiu formatime programesh të njohura e të reja ku gërshetohen problematika politike e shoqërore, emisione sportive, argëtuese, filma e dokumentarë, programe për ngjarje dhe evenimente me rëndësi për kulturën tonë kombëtare. (Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastrë, Festivali i Këngës në RTSH) etj.

Tërësia e programeve artistike e kulturore të RTSH-së synon të ofrojë më shumë edukim, argëtim, çlodhje e komunikim të drejtpërdrejtë me të gjitha kategoritë e shikuesve. Në këtë drejtim RTSH vijon t'u kushtojë vëmendje programeve të prodhuara vetë, varësisht prej mundësive financiare e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, por edhe prej përvojës së fituar në vite. Problematika e këtyre programeve synon të përfshijë çështje të mprehta të shoqërisë shqiptare, të historisë e të kulturës së shqiptarëve në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, e diasporë. Ajo realizohet përmes dokumentarëve, reportazheve, kronikave speciale apo portreteve, intervistave e gjinive të tjera televizive. Përmes tyre, por edhe me formatimet e reja të programeve të njohura, RTSH ka bërë hapa përpara, por ende vihet re se duhet të përfshihet në një dinamikë më intensive përballë konkurrencës së televizioneve private. Në rastet më të mira, siç janë emisionet për fëmijë e të rinj, RTSH ia del mbanë të realizojë misionin e tij si televizion në shërbim të publikut, pa i bërë lëshime cilësisë, nivelit të përmbajtjes e të transmetimit,

ruajtjes e vlerësimit të standardeve etike e të gjuhës së komunikimit përmes ekranit.

RTSH është përpjekur që me strukturën dhe përmbajtjen e programeve radiofonike e televizive të plotësojë detyrimin ligjor e qytetar ndaj taksapaguesve shqiptarë, për emisione të veçanta për emigrantët, për personat me aftësi të kufizuar, për minoritetet etnike e gjuhësore për të drejta të grave të dhunuara etj. Por problematika e mprehtë e domosdoshmëria e këtyre programeve duhet të shoqërohet edhe me një realizim në parametrat cilësorë të vetë programeve të tjera të RTSH-së.

### 3.5 Monitorimi

Edicionet e lajmeve dhe programet e aktualitetit, ku padyshim vendin kryesor e përbëjnë ato me temë “politikën”, vlerësohen si më të arrirat në median elektronike shqiptare. Përpjekjet e vazhdueshme për të ndryshuar programacionin në funksion të përballimit të konkurrencës midis operatorëve të ndryshëm, janë shoqëruar me rritjen e numrit të programeve të aktualitetit në përgjithësi dhe atyre politike në veçanti. Shpesh herë dhe temat kryesore dhe prononcimet më interesante të trajtuara në këto debate të mbrëmjes, janë lajmi i parë në edicionet informative të ditës së nesërme tek operatorët radiotelevizivë.

KKRT në vitin 2009, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka vazhduar të monitorojë programet informative në përgjithësi dhe edicionet e lajmeve në veçanti si dhe zbatimin e rregullave për transmetimin e reklamave nga ana e operatorëve radiotelevizivë në përputhje me kërkesat e ligjit.

#### 3.5.1. Raportet kohore për subjektet politike

Referuar monitorimit, në lidhje me “kohën e plotë” dhënë institucioneve qendrore dhe subjekteve politike, krahasuar midis vetë operatorëve radiotelevizivë, vërejmë se:

Institucioni i Presidentit, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te “Radio Tirana” me 8,46%, Kryeministri, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te televizioni “Klan” me 27,51%, Qeveria, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te “Televizioni Shqiptar” me 25,52%, Kuvendi, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te “Televizioni Shqiptar” me 7,64%, Partia Demokratike, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te televizioni “Klan” me 12,47% dhe Partia Socialiste, kohën e plotë më të madhe në përqindje e ka pasur te televizioni “Top Channel” me 37,73%.

Në “Televizionin publik Shqiptar”, gjatë edicionit kryesor të lajmeve, koha e plotë (e shprehur në %), vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së institucioneve dhe subjekteve politike paraqitet si më poshtë: Për Presidentin 4,27%, Kryeministrin 24,23%, Qeverinë 25,52% dhe Parlamentin 7,64%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është: Për Partinë Demokratike 11,76 %, Partinë Socialiste 15,94%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 5,62% dhe Partinë Republikane 1,25%

Në televizionin kombëtar “Klan”, gjatë edicionit kryesor të lajmeve, koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së institucioneve dhe subjekteve politike kryesore është: Për Presidentin 2,54%, Kryeministrin 27,51%, Qeverinë 23,16% dhe Parlamentin 4,82%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është: Për Partinë Demokratike 12,47%, Partinë Socialiste 18,79%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 5,45% dhe Partinë Republikane 1,79%

Në televizionin kombëtar “Top Channel”, gjatë edicionit kryesor të lajmeve, koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së institucioneve dhe subjekteve politike kryesore është:

Për Presidentin 5,10%, Kryeministrin 15,85%, Qeverinë 15,53% dhe Parlamentin 5,08%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është: Për Partinë Demokratike 6,64%, Partinë Socialiste 37,73%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 6,03% dhe Partinë Republikane 1,58%

Në Radio “Tirana”, gjatë edicionit kryesor të lajmeve, koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarisë së institucioneve dhe subjekteve

politike kryesore është: Për Presidentin 8,46%, Kryeministrin 26,60%, Qeverinë 22,72% dhe Parlamentin 6,42%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është: Për Partinë Demokratike 8,56%, Partinë Socialiste 19,77%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 4,27% dhe Partinë Republikane 0,90%

Në **“Top Albania Radio”**, gjatë edicionit kryesor të lajmeve, koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin e veprimtarive të institucioneve dhe subjekteve politike kryesore është: Për Presidentin 4,88%, Kryeministrin 14,10%, Qeverinë 19,25% dhe Parlamentin 4,25%.

Koha e plotë vënë në dispozicion për pasqyrimin veprimtarisë së partive politike është: Për Partinë Demokratike 5,56%, Partinë Socialiste 38,10%, Lëvizjen Socialiste për Integrim 7,56% dhe Partinë Socialdemokrate 1,33%

*(Për më shumë informacion në lidhje me të dhënat e mësipërme dhe të dhëna të tjera të monitorimit, mund t'i referoheni tabelave në anekset e këtij raporti).*

Edicionet kryesore informative të **radios kombëtare “Radio +2”** nuk monitorohen, pasi nuk ka edicione kryesore të plota lajmesh, mungon sinkroni si dhe nuk i transmeton ato gjatë gjithë ditëve të javës. Monitorimi i rregullt i tij u krye me sondazhe në muajt Qershor dhe Korrik, në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme të Qershorit 2009.

### **3.5.2. Raportet kohore për aktorët “sinkron”**

Referuar të dhënave të monitorimit gjatë vitit 2009, në lidhje me kohën sinkron, dhënë aktorëve të ndryshëm si përfaqësues të institucioneve ose subjekteve politike, krahasuar midis vetë operatorëve radiotelevizivë, vërejmë se: z. Bamir Topi (Presidenti) kohën sinkron më të madhe në përqindje e ka pasur te **“Radio Tirana”** me 6,71%, z. Sali Berisha (Kryeministër dhe kryetar i Partisë Demokratike) kohën sinkron më të madhe në përqindje e ka pasur te televizioni **“Klan”** me 31,36%, znj. Jozefina Topalli (Kryetare e Kuvendit) kohën sinkron më të madhe në përqindje e ka pasur te **“Televizioni Shqiptar”** me 4,06%, dhe Edi Rama (kryetar i Partisë Socialiste) kohën sinkron më të madhe në përqindje e ka pasur te televizioni **“Top Channel”** me 19,38%.

3.5.3. Raportet kohore për gjininë

Në lidhje me prezencën e aktoreve femra në median elektronike shqiptare, ka një përmirësim krahasuar me vitin e kaluar. Këtu ka ndikuar pozitivisht edhe ligji i ri zgjedhor që ka sjellë një pjesëmarrje më të lartë të gjinisë femërore në politikën shqiptare. Kjo vërehet qartë te raportet kohore (të shprehura në %) vënë në dispozicion të "Aktorit Sinkron", për secilin nga operatorët radiotelevizivë kombëtar.

Po t'i referohemi të dhënave të monitorimit do të vërejmë se "Televizioni Shqiptar", krahasuar me operatorët e tjerë radiotelevizivë, u jep aktoreve femra kohën sinkron më të madhe, me 12,69%. Ndryshe, ndodh me "Top Albania Radio" që aktoreve femra u jep kohën sinkron më të vogël me 9,91%.

TELEVIZIONI SHQIPTAR		
	Minuta	Përqindje
Femër	292,32	12,69%
Mashkull	2.011,27	87,31%

TELEVIZIONI KLAN		
	Minuta	Përqindje
Femër	212,02	10,91%
Mashkull	1.731,88	89,09%

TOP CHANNEL		
	Minuta	Përqindje
Femër	126,10	10,15%
Mashkull	1116,48	89,85%

RADIO TIRANA		
	Minuta	Përqindje
Femër	92,50	12,42%
Mashkull	652,08	87,58%

TOP ALBANIA RADIO		
	Minuta	Përqindje
Femër	41,72	9,91%
Mashkull	379,38	90,09%

3.5.4. Raportet kohore për temën e lajmit

Në të gjitha radiot dhe televizionet kombëtare, në radiotelevizionin publik tema të tilla si Politika, Veprimtaria e Presidentit, Veprimtaria e Qeverisë dhe Veprimtaria e Parlamentit zënë pjesën më të madhe të kohës gjatë edicioneve

kryesore të lajmeve. Koha (e shprehur në %) që vihet në dispozicion të këtyre temave, të marra së bashku, është më e madhe te radioja dhe televizioni publik dhe konkretisht te “Televizioni Shqiptar” 52,27%, “Radio Tirana” 51,7%, televizioni “Klan” 44,32%, televizioni “Top Channel” 33.64% dhe radioja “Top Albania Radio” 32,19% të kohës totale të lajmeve.

### 3.5.5. *Dukuri të veçanta për operatorët radiotelevizivë lokalë.*

Televizionet lokale në përgjithësi i respektojnë kërkesat e ligjit në lidhje me programet që përmbajnë informacion dhe fakte referuar realiteteve lokale, por që nuk kanë karakter tregtar. Kështu mund të përmendim emisionet e lajmeve, programet sportive, programet me tematikë sociale, ose që trajtojnë çështje të aktualitetit duke ftuar në studio specialistë të fushave përkatëse, por edhe përfaqësues të komunitetit dhe qeverisjes vendore.

Televizionet lokale përpiqen të trajtojnë edhe debatin politik, duke ftuar përfaqësues vendorë të partive politike por edhe të zgjedhur lokalë. Kështu mund të përmendim televizionin “6+1” (Vlorë), me emisionin në formatin “Bisedë në Studio”, televizionin “4 Plus” (Lushnjë), me emisionin “Edhe një plus” me të ftuar në studio analistë të medias ose politikanë, televizionin “Kombi” (Fier) me emisionin “Realitet” me të ftuar në studio e të zgjedhur lokalë, emisionin e aktualitetit “Avantazh” në televizionin “Alpo” Gjirokastrë ku diskutohen çështje që shqetësojnë komunitetin, programin e aktualitetit “Dimension” në televizionin “M+” që operon në prefekturat e Lezhës dhe Shkodrës etj.

Edicionet e lajmeve, në përgjithësi, transmetohen në format të rregullt, me studio dhe kronika përkatëse, si dhe duke përdorur sinkronin si një formë cilësore e trajtimit të lajmit. Ato janë të ndara sipas orareve të ndryshme. Temat mbizotëruese të kronikave janë problemet e përditshme që shqetësojnë komunitetin vendor, por njëkohësisht trajtojnë edhe çështje të politikës qendrore. Në përgjithësi respektohet paanshmëria dhe pluralizmi politik.

*3.5.6. Pasqyrimi i fushatës zgjedhore - Qershor 2009*

Sipas Kodit Zgjedhor, monitorimi i pasqyrimin të fushatës zgjedhore në median elektronike, bëhet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM). Pavarësisht kësaj, angazhimi i KKRT-së ishte maksimal në përshtatjen e metodologjisë së monitorimit, trajnimin e personelit të monitoruesve, përgatitjen e teknikës së nevojshme dhe infrastrukturës përkatëse në Studion e Monitorimit të KKRT-së etj. Vetëm për të realizuar me sukses monitorimin e fushatës zgjedhore 2009, nga KKRT u bënë investime të konsiderueshme në ristrukturimin e Studios së monitorimit. Monitorimi i pasqyrimin nga media elektronike i fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 ka qenë një nga detyrat më të rëndësishme të KKRT-së gjatë vitit 2009.

Ky proces u krye në bashkëpunim me Bordin e Monitorimit të Medias i ngritur nga KQZ-ja, i cili, në bazë të Kodit Zgjedhor, për kryerjen e monitorimit shfrytëzoi kapacitetet teknike të KKRT-së. Për nevojat e monitorimit, për rregullat, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve tona teknike, KKRT dhe KQZ në fillim të fushatës nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, e cila kishte si qëllim angazhimin e palëve për monitorimin e fushatës zgjedhore 2009 në radiot dhe televizionet në Republikën e Shqipërisë.

Në përgjithësi media, në edicionet e lajmeve, u tregua e paanshme ndaj pasqyrimin të fushatës zgjedhore të subjekteve politike që morën pjesë në të. Megjithatë pati një shmangie nga respektimi i raporteve kohore të barabarta gjatë debateve ose forumeve politike ose në transmetimin e reklamave politike por, duke marrë në konsideratë pozicionimet e operatorëve të ndryshëm kundrejt forcave politike, mund të themi se në tërësi fushata zgjedhore ka qenë e balancuar në media.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve thuhet se: “Gjatë periudhës 30 ditore zyrtare të fushatës, pasqyrimi sasior mbi partitë kryesore ishte më i balancuar. Gjithsesi, të gjithë transmetuesit e monitoruar shfaqën njëanshmëri qoftë kundrejt PD-së apo PS-së, gjë që u reflektua në tonin e pasqyrimin.”

Gjatë fushatës zgjedhore u evidentuan dukuri dhe probleme. Më poshtë po renditim disa prej tyre:

- Partitë më të mëdha në vend, parapëlqyen të mos merrnin pjesë në debatet politike të organizuara nga televizione të ndryshme. Kjo solli një shmangie nga respektimi i raporteve të drejta kohore në lidhje me këto lloj programesh.
- Dukuria e mospjesëmarrjes në debatet politike të televizioneve kryesore, u vazhdua edhe pas përfundimit të fushatës zgjedhore dhe ka krijuar diferenca në nivelin e përfaqësimit, e si pasojë kemi prirje për debat politik jo të balancuar. Kjo pjesëmarrje e diferencuar në debate justifikohet nga partitë politike, me qëndrimin editorial të televizioneve, që sipas pretendimit të partive binte ndesh me respektimin e paanshmërisë dhe pluralizmit.
- Fushata filloi realisht dy javë përpara afatit që përcakton Kodi Zgjedhor. Në këtë periudhë, gjatë edicioneve më të shikuara të lajmeve apo programeve të tjera informative, transmetuesit kanë bërë një pasqyrim jo të balancuar të veprimtarive të dy partive kryesore politike, në kundërshtim me dispozitat ligjore.
- Në përgjithësi radiotelevizionet treguan paanshmëri dhe respektuan pluralizmin politik gjatë edicioneve të lajmeve gjatë fushatës zgjedhore. Edhe në rastet kur lindi nevoja e kompensimit të partive të ndryshme me kohë televizive, ai u bë i mundur në edicionet e tjera që transmetoheshin gjatë ditës.
- Pjesa më e diskutueshme e monitorimit, ishin kronikat e lajmeve që pasqyronin aktivitetin e qeverisë gjatë fushatës zgjedhore. Në këtë rast u mbajt një qëndrim i veçantë për çdo aktivitet në varësi të rëndësisë ose natyrës së tij. Kështu mund të përmendim aktivitetet me rëndësi kombëtare, si përrurimin e rrugës Durrës-Kukës, ose pajisjen e qytetarëve me kartat e identitetit, ngjarje të cilat u konsideruan nga BMM si veprimtari e qeverisë. Përrurimet e reja që i përkisnin investimeve që do të kryheshin në të ardhmen, u konsideruan si fushatë zgjedhore.
- Pasqyrimi i aktivitetit të kryetarit të Bashkisë së Tiranës u shqyrtua rast pas rasti, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe për disa prej aktiviteteve të qeverisë në lidhje me përrurimet ose investimet e përshkruara më sipër.

- Dukuria më e përfulur, e vlerësuar si negative, që ka ndikuar në pasqyrimin jo profesional të veprimtarive të partive kryesore politike, ishte përgatitja e kronikave zgjedhore nga vetë subjektet politike. Media elektronike duke i transmetuar ato nuk u tregua profesionale. Kjo gjë u pranua edhe nga vetë përfaqësuesit e saj mbas mbarimit të fushatës elektorale.

Në ligj thuhet që lajmet dhe informacionet, që transmetohen nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, i paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë e të paanshme, nxisin formimin e lirë të mendimeve dhe nuk i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare, por ne asnjë rast nuk përmenden raportet kohore të cilat duhen respektuar nga operatorët radiotelevizivë. Po t'i referohemi ligjit aktual, përcaktohet qartë vetëm detyrimi i KKRT-së për monitorimin e edicioneve informative të transmetuara nga radiot dhe televizionet kombëtare.

KKRT sugjeron, duke u bazuar edhe në përvojën evropiane, që për kohën e plotë dhënë partive të mazhorancës, partive të opozitës, veprimtarive të institucioneve në edicionet informative, të respektohet "rregulli i 3/3". Sipas këtij rregulli, 30% e kohës t'i kushtohet veprimtarive të partive të mazhorancës, 30% pasqyrimin të veprimtarive të opozitës dhe 30% e kohës veprimtarive të institucioneve. Pjesa tjetër e kohës prej 10% i kushtohet pasqyrimin të veprimtarive politike të partive jashtëparlamentare.

### *3.5.7. Mbi zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave.*

Në një vit zgjedhor si 2009, kanë qenë të pashmangshme kërkesat për të transmetuar reklama të porositura nga partitë politike. Reklama të tilla të porositura janë vënë re sidomos në periudhën para zgjedhjeve të përgjithshme të muajit Qershor. KKRT i ka shqyrtuar materialet paraprakisht rast pas rasti dhe u ka sugjeruar mediave respektimin e ligjit në lidhje me reklamat politike.

Në ligjin ekzistues për median mungon një dispozitë ku të përkufizohet qartë reklama politike. Kjo do të shmangte keqkuptimet apo interpretimet nga ana

e subjekteve politike në lidhje me qëndrimin ndalues që ka mbajtur KKRT në raste të tilla. KKRT është e mendimit që përkufizimi i reklamës politike të pasqyrohet në projektligjin e ri për median. Eksperienca e vendeve të komunitetit evropian është e ndryshme. Në qoftë se për reklamat politike ka një qëndrim kategorik ndalues, përveç periudhave zgjedhore, për reklamat institucionale janë të përcaktuara qartë rastet e lejimit si dhe përmbajtja e tyre.

Një problem që vazhdon të shfaqet në ekranet e televizioneve janë edhe kronikat e lajmeve që transmetojnë aktivitete që shërbejnë për promovimin e kompanive të ndryshme, që mund të konsiderohen edhe “reklama të fshehta”. Për të tilla ngjarje është e vështirë të mbahet një qëndrim për shkak të vetë natyrës së lajmit, i cili trajtohet si lajm ekonomik. Ligji nr. 8410 datë 30.09.1998, i ndryshuar, nuk parashikon ndonjë rregullim për “reklamat e fshehta”. Projekt-ligji i ri parashikon rregullim ligjor të hollësishëm si për “reklamat e fshehta” ashtu edhe për “vendosjen e produktit”. “Vendosja e produktit” është çdo formë e reklamës/teleshitjes që konsiston në përfshirjen ose përmendjen e një produkti, shërbimi ose marke tregtare që shfaqet brenda një programi, përkundrejt pagesës ose shpërblimi të ngjashëm. Kjo dukuri është e pranishme në ekranet e televizioneve dhe shfaqet më shpesh në spektakle ose programe argëtuese. Rregullimi i saj ligjor garanton edhe ruajtjen e integritetit të programit radioteleviziv.

Në muajt nëntor - dhjetor 2009, KKRT organizoi monitorimin e operatorëve televizivë vendorë në rrethe me qëllim monitorimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, kryesisht në lidhje me reklamat dhe sponsorizimet.

Monitorimi konsistoi në respektimin e neneve 49 - 58 që përfshihen në Kreun VI “REKLAMA” dhe të neneve 59 - 63, Kreu VII “SPONSORIZIMI”.

Qytetet ku u realizua monitorimi ishin Korça, Elbasani, Vlora, Lushnja, Fieri dhe Shkodra.

Nga monitorimi është vënë re se televizionet lokale, në përgjithësi, i zbatojnë kërkesat e ligjit për transmetimin e reklamave. Një dukuri që ndikon në përmirësimin e situatës financiare të operatorëve nëpër rrethe, është që televizionet lokale kanë arritur të bëhen tërheqëse edhe për kompanitë e

mëdha të celularëve, gjë që pasqyrohet në përmirësimin e strukturës së tyre programore si nga ana cilësore, ashtu edhe nga shumëllojshmëria e saj.

Pavarësisht dukurive pozitive të vërejtura nga monitorimi, janë hasur edhe probleme, të cilat po i paraqesim sa më poshtë:

- a. Kohëzgjatja e blloqeve të reklamave ka raste kur shkon mbi 25 minuta brenda 1 orë transmetim. Ka momente kur televizionet sillen si “televizione tematike”, sikur të jenë të licencuara vetëm për transmetim reklamash.
- b. Vihen re raste kur reklamat nuk veçohen nga programi nëpërmjet mjeteve optike dhe akustike.
- c. Në televizionet që kanë format të “ekrani i ndarë” por jo vetëm, transmetohen reklama në ekranin e madh dhe njëkohësisht transmetohen reklama/njoftime me titra si dhe reklama në ekranin e vogël. Kjo mënyrë transmetimi shpërqendron vëmendjen e shikuesit, nuk është e ndershme dhe dëmton konkurrencën.
- d. Ka raste kur ndërputja e reklamave nuk bëhet sipas dispozitave të ligjit.
- e. Brenda edicioneve të lajmeve disa rubrika, si moti ose kursi i këmbimit të monedhës, sponsorizohen nga kompani të ndryshme.
- f. Vërehet dukuria e dyshimtë e transmetimit të filmave të ekranit të madh të kinemasë.
- g. Transmetohen programe me shenja dalluese të operatorëve radiotelevizivë të huaj ose logo tjetër.
- h. Ka raste kur transmetohen filma pa përkthim ose dublim në gjuhën shqipe.
- i. Ka raste kur televizionet heqin logon e tyre gjatë transmetimit të programeve dhe veçanërisht të filmave të ekranit të madh të kinemasë.
- j. Ka televizione që nuk transmetojnë programe që lidhen me realitetin lokal.
- k. Ritransmetim i të njëjtit program për më shumë se 240 minuta.

#### IV. RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

Gjatë vitit 2009 KKRT, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, për këtë vit, ka zhvilluar një volum më të lartë pune për planifikimin e spektrit të frekuencave në mbështetje të përmirësimit të mbulimit me sinjal televiziv të operatorëve ekzistues radio e televizivë, për monitorimin e shfrytëzimit të këtij spektri me synim të parandalohen interferencat e dëmshme dhe për identifikimin e transmetimeve të paautorizuara, duke ndikuar fuqimisht në krijimin e kushteve normale për zhvillimin e biznesit mediatik të operatorëve të licencuar.

##### 4.1. Planifikimi i rrjeteve numerike

Edhe gjatë vitit 2009, KKRT, bazuar në arritjet e vitit paraardhës, ka punuar intensivisht për përfundimin e planifikimit të rrjeteve numerike, për t'i hapur rrugë ndërtimit të këtyre rrjeteve në përputhje me karakteristikat teknike të miratuara në Aktet Finale të Konferencës rajonale për Planifikimin e Shërbimit të transmetimeve Numerike në Pjesë të Rajoneve 1 dhe 3 në bandat e Frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06).


Gjatë gjithë vitit 2009, KKRT-ja, në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Radiokomunikacioneve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), ka punuar intensivisht për përgatitjen e të dhënave përfundimtare të nevojshme për regjistrimin e Caktimeve Frekuencore Numerike në Planin GE-06.

Siç është raportuar në Raportin Vjetor 2008, KKRT, pasi kreu llogaritjet për konvertimin e allotmenteve në Caktime Frekuencore<sup>1</sup> i paraqiti ato në formatin e duhur teknik për regjistrim në ITU. Gjatë verifikimit nga Byroja e Radiokomunikacioneve, rezultoi se një numër caktimesh frekuencore i

---

<sup>1</sup> Shih Raportin Vjetor 2008, Përgatitja e dokumentacionit teknik për licencimin e rrjeteve numerike, pika 1, Hartimi i planit të Caktimeve Frekuencore (Konvertimi i allotmenteve në Caktime).

tejkalonin normat e vendosura të mbrojtjes, duke rrezikuar shkaktimin e interferencave në disa distanca e drejtimeve të caktuara. Për ilustrim, në fig 1 jepen rezultatet e llogaritjeve të interferencave që shkaktonte allotmenti i Shkodrës (AL001D) në 360 gradë në distancat 60, 100, 200, 300, 500 dhe 750 km nga qendra, të llogaritura me softëare-in e ri të ofruar këtë vit nga ITU (GE06 calc).



**Legjendë**


- Interferenca brenda normës
- - - - - Interferenca mbi normën

*Fig.1. Rezultatet e llogaritjes së interferencave të shkaktuara nga Allotmenti AL 001D*

Për të evituar interferencat, u rillogarit ERP dhe disa parametra të tjerë të stacioneve të projektuar në të gjitha pikat e transmetimit të identifikuar në territorin e Shqipërisë, sipas allotmenteve përkatës. Verifikimi i interferencave u krye duke përdorur software-in e përgatitur nga ITU, të emërtuar GE06 Calc, i cili nuk disponohej gjatë llogaritjes së parë.

Pas rillogaritjes, u hartuan njoftimet GT1 (GT1notices) në standardin e kërkuar nga ITU, për t'i shkarkuar këto të dhëna në sistemin WISFAT (Web Interface for Submission of Frequency Assignments/allotments (terrestrial Services- Ndërfaqja Web për parashtrimin e Caktimeve/Allotmenteve Frekuencore (Shërbimet tokësore)). Kjo është procedura zyrtare e përcaktuar nga ITU për regjistrimin e Caktimeve Frekuencore në Planin GE06, që legalizon përdorimin e caktimeve në fjalë në territorin e Shqipërisë.

Para shkarkimit të Njoftimeve GT1 në WISFAT, duke përdorur softëware-n e ofruar nga ITU (GE06 Calc, u krye verifikimi i caktimeve frekuencore të reja lidhur me interferencat e shkaktuara nga secili allotment shqiptar në 360 gradë në distancat koordinuese deri në 1000 km. Nga verifikimi rezultoi se të 354 njoftimet e përgatitura ndodheshin brenda standardeve të përcaktuara në dokumentin e Akteve Finale të Konferencës së Radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimeve të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06). Nuk u konstatua asnjë rast i tejkalimit të nivelit standard mbështjellëses së interferencave. Për ilustrim, në fig. 2 jepen rezultatet e llogaritjeve për allotmentin e Shkodrës, pas korrigjimit të parametrave:



#### Legjendë

- Interferenca brenda normës
- Interferenca mbi normën

*Fig.2. Rezultatet e llogaritjes së interferencave të shkaktuara nga Allotmenti AL 001D pas rillogaritjes së parametrave teknikë.*

Pas verifikimit, në datën 20.08.2009 u shkarkuan në WISFAT 354 Caktime frekuencore që përfaqësojnë të gjitha frekuencat UHF të parashikuara në Planin GE06 për Shqipërinë.

Me këtë regjistrim, tashmë janë konsoliduar bazat teknike për ndërtimin të rrjeteve numerike tokësore në Shqipëri, duke shmangur kontestimet nga vendet fqinjë.

Po punohet për përgatitjen e Njoftimeve GT1 edhe për Frekuencat VHF (DVB-T dhe T-DAB).

#### 4.2. Planifikimi i rrjeteve analoge

##### 4.2.1. *Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv) për licencimin e operatorëve të rinj, dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.*

Gjatë vitit 2009 KKRT për përmirësimin e mbulimit apo për licencime të reja ka përgatitur dokumentacionin teknik për 37 caktime frekuencore radio dhe TV që shtrihen pothuaj në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për këtë qëllim është dashur kryerja e matjeve në vend për shfrytëzimin e spektrit dhe zhurmat e ndryshme, konsultimi me data base-t e ITU për transmetimet në vendet fqinjë etj. Nga kontrollet dhe matjet është konstatuar se shfrytëzimi i spektrit në Shqipëri vazhdon të rëndohet, sidomos në zonat me interes të lartë (ultësira perëndimore deri në Sarandë, Zona e Korcës, etj) ndërsa nuk ka interes për mbulimin e zonave të largëta (Peshkopi, B. Curri, Ersekë).

Gjatë vitit 2009 është përgatitur dokumentacioni teknik për organizimin e konkurrimit të kandidatave për licencimin e operatorëve të rinj televizivë. Si rezultat i konkurrimit, u licencuan 8 operatorë të rinj vendorë privatë televizivë dhe u zgjerua zona e licencimit të TV "Ora" në qarkun e Vlorës (u hodhën në konkurrim 3 frekuenca për pikat transmetuese Zvërnec, Himarë, Mile).

Televizionit "News 24", në bazë të kërkesës për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së licencimit, i janë akorduar 2 frekuenca të tjera në pikat transmetuese Himarë dhe Delvinë (transmetues të instaluar në pika të ulëta dhe me Fuqi Efektive të Rrezatuar (ERP) të vogël).

Gjithashtu janë licencuar 13 operatorë vendorë privatë radio, i është zgjeruar zona e licencimit radio Dinamic Sound nga qyteti Tiranë në rrethin Tiranë-Durrës.

Gjithsej, gjatë vitit 2009, është përgatitur dokumentacioni teknik për 18 frekuenca për transmetime televizive vendore private dhe 19 frekuenca për transmetime vendore private radio FM (Shih tabelat Tb.1 dhe Tb.2 më poshtë).

KKRT, pasi bëri studimin e spektrit të frekuencave si për TV dhe radio FM, përcaktoi frekuencat e lira për konkurrim kandidaturash, bëri llogaritjet për mbulimin e zonës së licencimit si dhe llogaritjen për eliminimin e interferencave me sinjalet e tjera radio dhe televizive.

Bazuar në Ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998 “ Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, Neni 34, pika 4) operatori duhet të fillojë transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe 180 ditë në transmetimet e radio vendore dhe 270 ditë në transmetimet e televizionit vendor.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur operatorët e licencuar në vitin 2009 dhe gjendja e tyre faktike e transmetimit.

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT	PIKAT TRANSMETUESE	DATA E LICENCIMIT	GJENDJA FAKTIKE
1	TV K8	Qarku Vlorë	Zvërnec, Mile (2 frek)	30.01.2009	Jo në transmetim ( jashtë afatit)
2	TV Tele 4	Qarku Berat	B. Kala, Poliçan, Çorovodë (3 frek)	14.05.2009	Jo në transmetim (brenda afatit)
3	TV Jug	Qyteti Fier	Fier (1 frek.)	14.05.2009	Jo në transmetim (brenda afatit)
4	TV 7	Qyteti Lushnjë	Blerim Lushnjë (1 frek.)	14.05.2009	Ne transmetim
5	TV Elbasan	Qyteti Elbasan	Petresh (1 frek.)	14.05.2009	Ne transmetim
6	TV Rex	Qarku Korçë	Cervenakë, Çardhak (2 frek)	18.07.2009	Jo në transmetim (brenda afatit)
7	TV Glob	Rrethi Berat	Maja Partizan (1 frek.)	18.07.2009	Ne transmetim
8	TV AVN	Rrethi Fier, Mallakastër, Lushnjë	Ardenicë, Likovun 2009 (1 frek.)	06.11.2009	Leje frek. Në transmetim
9	TV Kombi	Rrethi Fier, Mallakastër, Lushnjë, Berat.	Fier, Likovun 2009 (1 frek.)	19.05.2009	Leje frek. Në transmetim
10	TV Ora	Rrethi Tiranë – Durrës, Qarku Fier,	F. Dajt, K. Ishëm (2008), Ardenicë, Zvërnec, Himarë 2009 (3 frek)	14.05.2009	Në transmetim në pikat Ardenicë,

**KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT**

		Qarku Vlorë			Zvernec, Himarë
11	Tv News 24	Prefekturat Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë	F. Dajt, K. Ishëm, Mile, Ardenicë, Zvernec, Delvinë, Himarë 2009 (2 frek)	19.05.2009	Leje frek. Në transmetim

*Tab.1. Frekuencat TV të dhëna për operatorët e rinj për zgjerimin e zonës së licencimit dhe për përmirësimin e mbulimit të operatorëve ekzistues*

NR	OPERATORI	ZONA E LICENCIMIT	PIKAT TRANSMETUESE	DATA E LICENCIMIT	GJENDJA FAKTIKE
1	Radio Jehona	Rrethi Shkodër	Tarabosh (1 frek.)	27.02.2009	Në transmetim
2	Radio Spartak SM	Bilisht	Qyteti Bilisht (1 frek.)	27.02.2009	Në transmetim
3	Radio Kiss	Rrethi Tiranë – Durrës	Fushë Dajt (1 frek.)	27.02.2009	Në transmetim
4	Radio Ora	Rrethi Tiranë – Durrës	Fushë Dajt (1 frek.)	27.02.2009	Në transmetim
5	Radio 4	Qyteti Berat	Berat Kala (1 frek.)	14.05.2009	Jo në transmetim (jashtë afatit)
6	Radio Jug	Qyteti Fier	Fier qytet (1 frek.)	14.05.2009	Në transmetim
7	Radio Take 5	Rrethet Tiranë- Durrës	Fushë Dajt (1 frek.)	14.05.2009	Jo në transmetim (jashtë afatit)
8	Radio Lushnja	Qyteti Lushnjë	Lushnjë qytet (1 frek.)	14.05.2009	Në transmetim
9	Radio Skan	Rrethet Tirane- Durrës	Fushë Dajt (1 frek.)	18.07.2009	Jo në transmetim (brenda afatit)
10	Radio 1	Rrethet Tiranë- Durrës	Fushë Dajt (1 frek.)	18.07.2009	Në transmetim
11	Dinamic Sound	Rrethi Tiranë – Durrës	F. Dajt (Zgjerim Zone)	18.07.2009	Në transmetim
12	Radio Nostalgjia	Qarqet Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë	Fushë Dajt, Mali Robit, Ardenicë, Himarë, Terbac, Zvernec, Mile (7 frek.)	09.11.2009	Në transmetim në pikën F. Dajt Jo në transmetim në pikat Mali Robit, Ardenicë, Himare, Tërbaç, Zvernec, Mile (brenda afatit)
13	Radio 4+	Rrethi Lushnjë	Vain (1 frek.)	09.11.2009	Në transmetim
14	Radio Vlora	Qyteti Vlorë	Vlorë qytet (1 frek.)	09.11.2009	Në transmetim

*Tab.2. Tabela e frekuencave Radio FM të dhëna për operatorët e rinj për zgjerimin e zonës së licencimit dhe për përmirësimin e mbulimit të operatorëve ekzistues.*

Siç paraqitet nga tabelat e mësipërme ka disa subjekte që nuk kanë dalë në transmetim edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar nga neni i cituar më sipër. Për këta operatorë po procedohet në përputhje me dispozitat ligjore që përcaktojnë paralajmërimin të ndjekur nga sanksionet, deri në heqjen e licencës.

#### *4.2.2. Puna për planifikimin e frekuencave analoge televizive për hapjen e vendit për transmetimet numerike*

Për të siguruar zbatimin e plotë të Planit Kombëtar të Frekuencave Numerike do të duhet transferimi i rreth 45 stacioneve ekzistues analogë në frekuenca të tjera transmetimi. Duke ditur se ndërtimi i rrjeteve numerike do të realizohet gradualisht gjatë viteve, detyra për hapjen e vendit për transmetimet numerike bëhet më e lehtë. Sidoqoftë gjatë planifikimit të frekuencave për përmirësimin e mbulimit me sinjal, apo edhe për licencime të reja, KKRT nuk planifikon frekuenca që bëjnë pjesë në planin numerik.

Për mbulimin e shpenzimeve të transferimit në frekuenca të tjera, ligji nr. 8410 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" (neni 3, pika 7) përcakton: *"Në rastet kur, për implementimin e Planit të Frekuencave në koordinim me vendet fqinje, një frekuencë lëshuar një operatori të licencuar për transmetime analoge kërkohet për ngritjen e një rrjeti numerik, KKRT i lëshon operatorit analog një frekuencë tjetër për të mbuluar të njëjtin territor. Shpenzimet për ndryshimin e frekuencës përballohen nga KKRT-ja",*

Ndërsa janë planifikuar fondet e nevojshme, KKRT po punon për përcaktimin e modaliteteve të realizimit të kësaj detyre. (Preventivi mesatar i transferimit për stacione transmetues të përhapur në territorin e Shqipërisë, miratimi dhe lëvrimi i fondeve etj).

Gjatë këtyre kontrolleve është venë re një përmirësim i interferencave të dëmshme nga stacionet e vendeve fqinjë, për shkak të kalimit të tyre intensiv në transmetimet numerike (sidomos Italia).

#### 4.3. Monitorimi i shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Sektori i Monitorimit bazuar edhe në eksperiencën e fituar vitin të kaluar, gjatë vitit 2009 ka mbështetur më cilësisht KKRT-në në mbajtjen e regjimit të vendosur të transmetimeve radio e televizive ekzistuese, në identifikimin e lokalizimin e transmetimeve të paautorizuara dhe në ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së për sanksionet ndaj operatorëve të ndryshëm.

Edhe për vitin 2009, veprimtaria e monitorimit është zhvilluar bazuar në një plan veprimi të miratuar nga titullari i KKRT-së që parashikonte inspektimin e shfrytëzimit të spektrit në gjithë territorin e Shqipërisë me një periodicitet dy herë në vit.

Krahas inspektimit të planifikuar, për sinjalet radio e televizive që mund të kapen nga Tirana (kryesisht për sinjalet që mbulojnë hapësirën Tiranë-Durrës), është organizuar monitorimi ditor i cili regjistron ditë për ditë gjendjen e transmetimeve.

Evidentimi i saktë dhe ndjekja e përditshme ka bërë që të mbahet nën kontroll regjimi i transmetimeve, sidomos në zonën e rënduar Tiranë-Durrës, ku me të konstatuar një anomali, është ndërhyrë menjëherë për të stabilizuar situatën. Nga monitorimet e kryera gjatë vitit 2009 kanë dalë problemet e mëposhtme:

##### 4.3.1. Transmetimet e palicencuara (Shfrytëzim i paautorizuar i spektrit):

###### a. Transmetimet e "Vizion+"

Me Vendimin nr. 677, datë 18.02.2008, KKRT ka licencuar shoqërinë "Media Vizion" për televizionin privat satelitor "TV Vizion+", për një periudhë prej 8 vjetësh. Sipas pikës 4 të këtij vendimi, licenca me nr. 038/TVL (me zonë licencimi qarqet Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë), për subjektin televiziv privat vendor "TV Vizion+" është bërë e pavlefshme (sipas kërkesës së vetë subjektit).

Me marrjen e licencës satelitore, këtij subjekti, konform nenit 136/1 të ligjit 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i lind e drejta të ritransmetojë programin e tij edhe në rrugë tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vijim të kësaj procedure subjekti ka depozituar kërkesën për të ritransmetuar programin e tij edhe në rrugë tokësore, por KKRT ende nuk ka marrë vendim. Kjo pasi procedurat e parashikuara nga aktet nënligjore që rregullojnë këtë problem nuk janë të plota. **Aktualisht subjekti “TV Vizion+” transmeton në të gjithë zonën ku më parë ka operuar si operator vendor dhe KKRT po punon për zgjidhjen e shpejtë të këtij problemi.**

**b. Transmetimet e Klan TV**

Operatori televiziv privat kombëtar TV Klan i është drejtuar zyrtarisht KKRT-së për të ndërruar kanalën e transmetimit për zonën e Tiranës për shkak të interferencave nga një kanal kroat. Në përmbushje të detyrimit ligjor për të siguruar transmetime pa interferenca, KKRT duhej të zhvillonte disa procedura negociimi me administratën kroate. Këto negociata kërkonin kohë dhe nuk parashikonin të sillnin ndonjë garanci për zgjidhje, pasi transmetimet në fjalë janë të regjistruara në emrin e Kroacisë në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave. Të ndodhur përpara kësaj rrethane, si dhe nisur nga fakti se spektri frekuencave televizive për zonën e Tiranës është i mbingarkuar, KKRT, për kohësisht vendosi të lejojë TV Klan të transmetojë në kanalën 30 UHF. Operatori televiziv privat kombëtar TV TVA, i autorizuar për të transmetuar në këtë kanal, kishte një periudhë gati mbi 1 vjeçare që i kishte ndërprerë transmetimet e tij. Leja për të transmetuar në kanalën 30 është leje e përkohshme, deri në zgjidhjen e problemeve teknike.

**c. Transmetimet e Elrodi Music (ish Alb-west) Vorë**

Ky subjekt është licencuar si operator lokal i transmetimeve televizive analoge tokësore me zonë licencimi Bashkinë Vorë. Me kohë ky subjekt ka bërë kërkesa për shtrirjen e mbulimit edhe në qytetin e Tiranës. Çështja është diskutuar në disa mbledhje të Këshillit. Zgjerimi i zonës së licencimit në qytetin e Tiranës do të kërkonte organizimin e konkurrimit të kandidaturave (Neni 21 i ligjit 8410), ku do të merrnin pjesë të gjitha subjektet e interesuara. Theksojmë se kërkesat për ofrimin e shërbimeve televizive në qytetin e

Tiranes janë shumë të larta. Gara nuk mund të organizohet për mungesë frekuencash në këtë zonë të mbingarkuar. Me gjithë përgjigjet negative të Këshillit, Albwest ka ngritur fuqinë e transmetimit në mënyrë të paautorizuar, duke bërë që sinjali i tij të mbulojë edhe Tiranën. Grupi i inspektimit, pas shumë paralajmërimesh, e ka ndëshkuar këtë subjekt me gjobë, e cila më pas i është anuluar nga KKRT.

#### *4.3.2. Transmetime numerike në kanalet e licencuara si analoge*

Përveç transmetimeve numerike tokësore në kanal 59, "Tring" transmeton edhe në një kanal tjetër (CH 47 UHF) i cili është licencuar nga KKRT për transmetimin e programeve analoge tokësore të subjektit Dardan TV. Ky kanal nuk bën pjesë në Planin e frekuencave numerike të Shqipërisë. KKRT së shpejti do të dalë me vendimin përkatës për këtë ndryshim.

KKRT nga monitorimi i spektrit konstatoi **transmetime numerike në kanal 53 UHF**. Në bazë të këtij informacioni fillestar, KKRT organizoi inspektimin në pikën e transmetimit në malin e Dajtit, përcaktoi vend ndodhjen e stacionit transmetues të palicencuar dhe mori masa për mbylljen e tij. Aktualisht këto transmetime janë ndërprerë.

Po kështu, nga specialistët e monitorimit të KKRT, janë konstatuar subjekte që transmetojnë programe të mbështetura në transmetime numerike të palicencuara, dhe që aplikojnë standarde teknike të pamiratuara. Përmendim rastin e qytetit të Peshkopisë (**kanali 28 UHF**) ku, pas identifikimit të autorit, KKRT, në bashkëpunim me policinë tatimore, ka marrë masa për mbylljen e transmetimeve numerike të paautorizuara duke lëshuar urdhrin përkatës. Theksojmë se bashkëpunimi me policinë tatimore, sidomos në rastet kur kërkohet ndërhyrje energjike për mbyllje transmetimesh pa leje apo sekuestrime lë shumë për të dëshiruar.

#### *4.3.3. Rrjete kabllore të palicencuar*

Gjatë inspektimeve në territorin e vendit është konstatuar një numër operatorësh kabllorë kryesisht në komuna e fshatra të veçuar (zona e

Myzeqesë, Berati, etj) që operojnë pa licencë të lëshuar nga KKRT. Masat e KKRT për zgjidhjen e këtij problemi jepen me hollësi në Kapitullin II.

#### *4.3.4. Operatorë vendorë të transmetimeve analoge tokësore që kanë ndërprerë transmetimet*

Nga inspektimet në terren ka rezultuar se ka disa subjekte të licencuara si operatorë TV lokalë të transmetimeve analoge tokësore si p.sh. në Peshkopi (TV Dibra Vizion dhe TV D1), etj. që kanë fikur transmetuesit.

Gjatë vitit 2009 është konstatuar mbyllja masive e stacioneve transmetues të operatorit televiziv kombëtar TVA, për shkak të problemeve ekonomiko-financiare të këtij subjekti.

KKRT, pas evidentimit të operatorëve që kanë ndërprerë transmetimet, ka bërë paralajmërimet përkatëse për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit. Por, me gjithë paralajmërimet, TVA nuk ka mundur të dalë në transmetim. Për këtë arsye, KKRT, me vendimin nr. 897, datë 22.12.2009 i ka hequr licencën këtij subjekti.

#### *4.3.5. Rritje e paautorizuar e fuqisë së transmetimit*

KKRT konstaton se edhe këtë vit rritja e paautorizuar e fuqisë së transmetimit nga pothuaj të gjithë operatorët që kanë instaluar stacione transmetues në malin e Dajtit, ka shkaktuar herë pas here interferenca, sidomos midis kanaleve fqinjë. Me ndërhyrjet e saj, KKRT është përpjekur t'i mbajë interferencat në nivel minimal. Ndërhyrjet janë realizuar në formën e paralajmërimeve dhe kur këto të fundit nuk kanë dhënë rezultat, janë ndërmarrë sanksionet e parashikuara në ligjin nr. 8410, datë 30. 09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë".

#### **4.4. Përgatitjet për transmetimet numerike**


Vendet e BE kanë përparuar në implementimin e rrjeteve numerike dhe mbylljen e transmetimeve analoge. Disa prej tyre tashmë kanë arritur në

transmetimet 100 % numerike. Parashikohet që procesi të përfundojë brenda 1 Janarit 2012 (me përjashtim të Greqisë që parashikon vitin 2015)

Gjithë rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore aktualisht është në procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike. Shumica e këtyre vendeve kanë hartuar strategjitë e kalimit në numerik, kanë përshtatur kuadrin ligjor dhe kanë përcaktuar Planin e Veprimit për implementimin e rrjeteve numerike e mbylljen e transmetimeve analoge. Shumica e këtyre vendeve parashikojnë mbylljen e transmetimeve analoge brenda 1 janarit 2012.

Shqipëria ndodhet në një moment kyç të procesit të vendimmarrjes drejt kalimit në transmetimet numerike, që konsiderohet edhe si një nga kushtet për hyrjen në BE. Ndonëse me ligj është përcaktuar mbyllja e transmetimeve analoge brenda 31.12.2012, strategjia e kalimit dhe financimet mbështetëse përkatëse nuk janë miratuar akoma. Një projekt i parë i Strategjisë së Kalimit në Transmetimet Numerike, me propozimet përkatëse, i është dërguar nga KKRT-ja Kuvendit, Kryeministrit dhe institucioneve e organizmave që kanë lidhje me mediat elektronike.

Projekti i Strategjisë parashikon, si hap të parë, ngritjen e një Task Force që do të shoqërojë të gjithë procesin, e cila do të koordinojë të gjithë veprimtarinë shtetërore e private në funksion të arritjes së objektivave që do të vendosen. Stabilizimi i një institucioni të tillë duhet të mbështetet me fondet përkatëse.



*Fig. 3. Pikat kryesore të transmetimit numerik dhe diagramat e antenave*




Fig. 4. Mbulimi me sinjal numerik i planifikuar të arrihet nga vënia në punë e pikave kryesore të transmetimit numerik

4.5. Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.

4.5.1. *Televizioni publik*

Gjatë vitit 2009, në zbatim të planit për lirim të frekuencave numerike të hartuar nga KKRT, TVSH ndryshoi kanalën e stacionit të tij në pikën transmetuese të malit të Dajtit nga kanali 57 UHF (i planifikuar për transmetime numerike), në kanalën 40 UHF. Aktualisht TVSH transmeton nga mali i Dajtit programe të mbështetura në teknikën analoge në të dyja kanalet (TVSH1 dhe TVSH2).

Ndërtimi i rrjetit të dytë analog për RTSH, megjithëse i diktuar nga ligji nr.8410, konsiderohet si joefektiv në kushtet e kalimit iminent në transmetimet numerike (viti 2012)<sup>2</sup>.

Sipas ligjit 8410 të gjitha frekuencat që janë në përdorim të RTSH-së, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjeçare. Në ligj nuk ekzistojnë indikacione të tjera për rregullimin e mëtejshëm. Gjatë periudhave të mëparshme, me kërkesë të RTSH, KKRT ka autorizuar përdorimin e frekuencave në pika të ndryshme. Por ekziston edhe një praktikë, kur RTSH ka instaluar stacione transmetues në pika të ndryshme pa marrë autorizimin e KKRT-së, duke shkaktuar në disa raste edhe interferencë në transmetimet e operatorëve të licencuar, për të cilët KKRT ka detyrimin t'i mbrojë nga interferencat. Një shembull tipik është ndërhyrja e shkaktuar në transmetimet e operatorit lokal TV Klaudiana (Peqin, Ch 24), nga stacioni i TVSH i instaluar pa autorizimin e KKRT në pikën e Ardenicës. KKRT po bashkëpunon me drejtuesit e RTSH për zgjidhjen përfundimtare të transmetimeve të paautorizuara, nëpërmjet ristudimit të mbulimit me sinjal të RTSH të territorit të vendit, i cili do të miratohet bashkërisht nga KKRT dhe RTSH.

Me RTSH po punohet edhe për rakordimin e të dhënave për stacionet radio FM.

---

<sup>2</sup> Shih Raporti Vjetor i KKRT për vitin 2008

Figurat e mëposhtme (Fig.5 dhe 6) pasqyrojnë mbulimin e territorit shqiptar me sinjalin e TVSH.




Fig. 5 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën VHF i realizuar nga TVSH




Fig. 6 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën UHF i realizuar nga TVSH

4.5.2. *Operatorët privatë kombëtarë*

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

Siç shihet në tabelë, mbulimi i TVA në fund të vitit 2009 është 0.

Vitet	Emërtimi	TVSH	R.Tirana	TVA	TV Klan	R.T. Alb	Radio +2	TV Top Channel
		Publik	Publik	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2002	Viti lic. 2008
2002	Viti i licencimit	----	----	2	2	2	----	----
	Kushtet e licencës	----	-----	7.33	7.33	28.85	----	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	27.39	40.91	87.22	-----	----
2003	Viti i licencimit	----	-----	3	3	3	1	----
	Kushtet e licencës	----	-----	26.4	26.4	55.76	10.11	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2004	Viti i licencimit	-----	-----	4	4	4	2	
	Kushtet e licencës	----	-----	46.97	46.97	72.69	28.87	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2005	Viti i licencimit	----	-----	5	5	5	3	
	Kushtet e licencës	----	-----	62.09	62.09	94.4	55.76	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2006	Viti i licencimit	----	-----	6	6	6	4	
	Kushtet e licencës	----	-----	75.71	75.71	90	72.68	----

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	----
2007	Viti i licencimit	----	-----	7	7	0	5	----
	Kushtet e licencës	----	-----	86.86	86.86	90	94.4	----
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	----
2008	Viti i licencimit	----	-----	8	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	90	50
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	40.8	69.8	87.22	72.64	62.1
2009	Viti i licencimit	----	-----	8	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	-----	90	90	90	50
	Mbulimi faktik	73.31	80.54	-----	70.2	87.22	72.64	62.1

*Tab.3. Zgjerimi i mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizivë*

Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB ( $\mu\text{V/m}$ ).

#### 4.5.2.1. Operatori Kombëtar TVA

Gjatë viteve 2008 dhe 2009 është vënë re një regres i plotë në veprimtarinë e operatorit kombëtar privat TVA. Nga inspektimet teknike të organizuara në gjithë territorin e vendit është konstatuar një reduktim gradual e i vazhdueshëm i zonës së mbulimit, deri sa në transmetim mbeti për disa kohë vetëm stacioni i instaluar në pikën e transmetimit në Dajt. Së fundi edhe ky stacion pushoi së transmetuari më 15.04.2009.

KKRT, me Vendimin nr. 897 të datës 22.12.2009 “Për mosrinovimin e licencës” revokoi licencën për TVA.

4.5.2.2. Operatori Kombëtar TV KLAN

Operatori Kombëtar TV KLAN vazhdon të tregojë stabilitet në mbulimin e territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. Edhe gjatë vitit 2009 TV KLAN ka bërë përpjekje për përmirësimin e mbulimit dhe ka bashkëpunuar me KKRT për identifikimin e zonave ku nevojitej ndërhyrje për përmirësim. Si rezultat, është instaluar një numër përsëritësish të rinj në pikat sekondare të rrjetit. Aktualisht TV KLAN ka instaluar stacione transmetues e përsëritës në 36 pika kryesore transmetimi. Megjithatë KLAN TV nuk e ka arritur akoma nivelin e mbulimit të përcaktuar në kushtet e licencës.

TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.




Fig.7. Pikat e transmetimit të TV KLAN




Fig. 8. Mbulimi me sinjal analog tokësor realizuar nga TV KLAN

#### 4.5.2.3. Operatori Kombëtar TV TOP CHANNEL

Me shpalljen e televizionit Top Channel si Operator Televizion Privat Kombëtar u akorduan nga KKRT frekuencat për 32 pika transmetuese (shih fig. 9) më poshtë. Deri në fund të vitit 2008 ky operator kishte realizuar transmetimin në 18 pika transmetuese ekzistuese dhe të reja, që realizon një

mbulim të territorit të Republikës së Shqipërisë deri në 62 %. Gjatë vitit 2009, Top Channel nuk ka njoftuar KKRT-në për instalimin e stacioneve transmetues në pika të tjera, sipas planit që përmban licenca. Kështu mbulimi i territorit të Republikës nga TV Top Channel mbetet në nivelin 62 %.

Nuk disponohen të dhëna për gjendjen e studiove të Top Channel-it nëpër rrethe, ndaj po punohet për saktësimin e kësaj situatë.




Fig. 9. Pikat e transmetimit të TV TOP CHANNEL




Fig.10. Mbulimi me sinjal analog tokësor i TV TOP CHANNEL

#### 4.5.3. Operatorët privatë vendorë

Edhe gjatë vitit 2009 peizazhi audiovizual në Shqipëri u plotësua me operatorë të rinj radio (FM) dhe televizivë tokësorë të teknologjisë analoge, kryesisht në zona ku spektri i radiofrekuencave lejonte hapësira të lira. Këto shtesa kanë sjellë rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të frekuencave, gjë që ka krijuar vlera të reja, monetare dhe kulturore sidomos në favor të komuniteteve lokale.

Informacioni për mbulimin e realizuar nga secili prej operatorëve radio apo televizivë të licencuar, jepet bashkëngjitur. Nga informacioni rezulton se ka disa operatorë që kanë investuar për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së tyre të licencimit si dhe kanë zgjeruar aktivitetin në zona të reja me vazhdimësi gjeografike.

Operatorët që rezultojnë me mbulim më të ulët të zonës së licencimit vazhdojnë të jenë:

TV Gramshi	7.2 %
TV Berati	Nga 6.2 % vitin e kaluar në 14.72 % në vitin 2009

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

Tirana TV	Nga 42 %, në 42.53 %
Supersonic	Nga 61 %, në 61.24 %

Televizione me mbulim të mirë

UFO (ish Teuta TV) 78.32 %  
si dhe disa TV të vogla, (TV 4+, Klodiana, etj)

Në transmetimet radiofonike, situata paraqitet e pandryshuar, me përjashtim të licencimit të disa operatorëve të rinj.

4.6. Transmetimet numerike ekzistuese

4.6.1. Digitalb

Prej korrikut 2004, shoqëria Digitalb ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore (4 rrjete fikse dhe 1 mobil) duke mbuluar një territor me madhësi mbi 1/3 e Shqipërisë.

Digitalb tashmë është licencuar si operator numerik satelitor. Në këtë sistem ai ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 11. Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik të Digitalb




Fig. 12. Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik DVB-H (mobil) të DigitAlb

#### 4.6.2. *Tring*

Në sistemin numerik tokësor Tring ka ndërtuar dy rrjete fikse për të cilat përdor dy kanale *Ultra High Frequency* (UHF) (Ch 59 dhe ch 47), nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në malin e Dajtit duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës.

Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT për TV Vizion+, përcakton përdorimin e kanalit 59, nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit. Kjo leje përcakton edhe kushtin që në mbarim të afatit të përcaktuar nga kjo leje, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga TRING.

TRING tashmë është licencuar si operator numerik satelitor. Në këtë sistem ai ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 13. Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor TRING

#### 4.6.3. Shijak TV

Në sistemin numerik tokësor Shijak TV ka ndërtuar një rrjet fiks, për të cilin përdor 1 kanal UHF nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit, duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës. Aktualisht për transmetimin numerik, Shijak TV përdor kanalën 24 UHF, ndërsa Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT, përcakton

përdorimin e kanalit 44, nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në qytetin e Tiranës. Leja e përkohshme përcakton edhe kushtin që në mbarim të afatit të përcaktuar nga kjo leje, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga Shijak TV, por nga të dhënat që disponon KKRT, rezulton se eksperimenti nuk ka arritur rezultatet e synuara tekniko-ekonomike.

Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, përfshirë operatorët me shtrirje të konsiderueshme në territorin e Shqipërisë, si Digitalb-i, realisht janë faktorë përcaktues për transmetimin numerik në Shqipëri dhe zotërojnë tashmë, për nga aktivitetet dhe njohuritë, një pozicion të pamohueshëm në procesin e kalimit në numerik në Shqipëri.

Operatorët privatë që aplikojnë teknologjinë numerike i sigurojnë të ardhurat përmes abonimeve dhe reklamave.




Fig. 14. Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor Shijak

Siç u paraqit më sipër, situata e transmetimeve numerike tokësore është krejtësisht e parregulluar, për pasojë e pakontrolluar. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, përfshirë operatorët me shtrirje të konsiderueshme në territorin e Shqipërisë, si Digitalb-i, operojnë pa licencat përkatëse që përcaktojnë rregullat dhe kushtet e shërbimit, si dhe detyrimet përkatëse financiare duke shtrembëruar tregun në dëm të operatorëve analogë të licencuar rregullisht.

#### 4.7. Analiza e dështimit të licencimit të rrjeteve numerike tokësore privatë kombëtare

Në përpjekje për të identifikuar shkaqet objektive të dështimit të licencimit të operatorëve numerike private kombëtare<sup>3</sup>, KKRT, gjatë vitit 2009 organizoi një seri takimesh e konsultimesh me aktorët e tregut dhe sidomos me subjektet që paraqitën interes për t'u licencuar dhe më vonë u tërhoqën. U insistua më shumë të merrej opinioni i subjekteve që aktualisht ofrojnë rrjete dhe shërbime të transmetimeve numerike, të cilët, në kushtet e ekzistencës së kuadrit ligjor (ligji i transmetimeve numerike dhe rregullorja përkatëse e licencimit) nuk mund të vazhdojnë më operimin pa iu nënshtruar regjimit të rregullimit të imponuar nga ky kuadër. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur arsyet apo pretendimet e paraqitura nga secili prej subjekteve të kontaktuara.

##### *4.7.1. Arsyet kryesore të paraqitura nga kandidatët për mosparaqitjen në garë pas regjistrimit*

Arsyet e paraqitura nga kandidatët për mospjesëmarrjen në garë, mund të përmbledhen:

- Konkurrentët nuk janë në të njëjtat kushte;
- Paqartësi mbi marrëdhëniet midis operatorit të rrjetit dhe operatorit të programeve;
- Operatorët nuk janë të përgatitur për të marrë vendime me rëndësi strategjike;
- Për përmasat e disa subjekteve, zgjidhja më e përshtatshme do të ishte licencimi për platforma rajonale;
- Paqartësi mbi menaxhimin e rrjeteve kombëtare, rajonale, lokale;
- Ligji në fuqi nuk është i zbatueshëm;
- Format e pronësisë të operatorit të rrjeteve numerike të përcaktuara nga legjislacioni ekzistues nuk janë të përshtatshme;
- Kapitali 10 miliard lekë vlerësohet shumë i madh;
- Të dy palët (shteti dhe operatorët) duhet të marrin përgjegjësitë dhe financimet për dixhitalizimin. Roli i KKRT duhet të forcohet në

---

<sup>3</sup> Shih Raporti Vjetor i KKRT për vitin 2009

kuptimin që të marrë masat për dixhitalizimin: Do ta ndërtojë shteti apo do të ndërhyjnë privatët?

- Nuk duhet ngatërruar transmetimi i programeve me Pay TV.
- Kushtet për licencim dhe pagesat janë shumë të larta;
  - o Vlera e kapitalit që kërkohet është shumë e lartë;
  - o Pagesa vjetore për licencë është shumë e lartë;
  - o 10 % e kapitalit të si garanci është shumë e lartë;
- Mosmiratimi i Strategjisë së kalimit në transmetime dixhitale;
- Ekzistenca në treg e një numri dekoderësh të sistemit MPEG 2, ndërrimi i të cilëve do të kushtojë shumë;
- Roli i rregullatorit është të nxisë digitalizimin duke përcaktuar edhe skemën e subvencionit;
- Përqendrimi i transmetuesve në një pikë për të përdorur të njëjtën infrastrukturë nuk funksionon në kushtet e Shqipërisë; etj.

#### *4.7.2 Arsyet e identifikuara nga KKRT që vështirësojnë procesin e licencimit*

KKRT analizoi me hollësi të dhënat e grumbulluara nga informacionet e marra prej subjekteve të paraqitur më sipër (4.7.1.) si dhe gjendjen e përgjithshme të tregut mediatik shqiptar, kuadrin ekzistues ligjor, etj, duke u munduar të evidentojë dhe shmangë nga analiza arsyet subjektive të kandidatëve, sidomos të kandidatëve që ofrojnë rrjete dhe shërbime numerike të palicencuara, të cilët, natyrisht janë të interesuar të ruajnë pozitat dhe avantazhet e fituara në treg.

Analiza zbuloi disa probleme që efektivisht pengojnë procesin e licencimit. Këto probleme të karakterit ligjor apo joligjor renditen më poshtë.

##### **4.7.2.1. Diferenca të ndjeshme midis kandidatëve konkurrues**

Ligji “Për transmetimet numerike në territorin e Shqipërisë”, për dhënien e licencës së operatorit të rrjetit numerik, parashikon konkurrimin e kandidaturave duke përcaktuar një numër kriteresh të cilat duhen respektuar njëjllë si për operatorët që aktualisht disponojnë dhe operojnë rrjete numerike tokësore, ashtu edhe për ata që dëshirojnë të ndërtojnë një rrjet të tillë. Kjo gjendje krijon pabarazi në konkurrim. Për ndërtimin e rrjeteve ekzistuese janë shpenzuar fonde të konsiderueshme, pavarësisht se ndërtimi është bërë jashtë

kuadrit ligjor. Ky konstatim mbështetet nga pohimi i TV Telesport se konkurrentët tanë janë një hap më para se ne. (shih 4.7.1.1.)

#### 4.7.2.2. Kuadri ligjor i pamjaftueshëm

Mediat elektronike në Shqipëri rregullohen në bazë të dy ligjeve kryesore: nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" dhe nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë". Ligji i parë është konceptuar kryesisht për rregullimin e transmetimeve analoge, kurse ligji i dytë është një përpjekje për të rregulluar disa aspekte të transmetimeve numerike, me referenca ndaj neneve të veçanta të ligjit nr. 8410, për çështje të rregullimit të programeve, të drejtave të autorit, etj.

Ligji në fuqi i transmetimeve numerike është konsideruar i pamjaftueshëm edhe nga ekspertët të huaj. Për të kapërcyer këtë pamjaftueshmëri, Komisioni Parlamentar i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, ka ngritur një grup pune për hartimin e një ligji integral për rregullimin e transmetimeve radiotelevizive në Shqipëri.

Disa nga mungesat kryesore të kuadrit ligjor, që pengojnë rregullimin e plotë të transmetimeve numerike përmenden më poshtë:

1. Ligji nuk përcakton saktë shërbimet që ai rregullon dhe shkallën e rregullimit të secilit shërbim në varësi të specifikave të tij dhe shkallës së përdorimit të pasurive kombëtare.

Të dy ligjet që aktualisht rregullojnë fushën e transmetimeve radiotelevizive, përcaktojnë dy kategori licencash:

1. licenca për ndërtim dhe mirëmbajtje rrjetesh (Operator Rrjeti) dhe
2. licenca për programet (Operator Programesh).

Ekziston edhe një **aktivitet i tretë** cili aktualisht nuk rregullohet nga ligjet në fuqi: Shërbimet e Komunikimeve Elektronike. Sipas përkufizimit të dhënë në Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 7 Marsit 2002 "Mbi një kuadër të përbashkët Rregullator për rrjetet dhe shërbimet e Komunikimit Elektronik" (Direktiva Kuadër), Neni 2, pika c) "**Shërbim i komunikimit**

**elektronik**”: është një shërbim, normalisht i ofruar kundrejt shpërblimit, i cili konsiston tërësisht apo kryesisht në dërgimin e sinjaleve në rrjetet e komunikimit elektronik, përfshirë shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimet e transmetimeve në rrjete të përdorura për transmetim, me përjashtim të shërbimeve që japin apo ushtrojnë **kontrollin mbi përmbajtjen** e transmetuar duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 98/34/EC.

Pra, ligji i ri duhet të përcaktojë rregullat për ofrimin e shërbimeve të Komunikimeve elektronike, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

Mungesa e rregullave për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, vështirëson organizimin e **buketave programore** dhe në përgjithësi organizimin dhe administrimin e shfrytëzimit të platformave numerike.

2. Ligji nuk përcakton qartë dallimet midis programeve që transmetohen hapur dhe programeve pay per view dhe kushtet specifike të ofrimit të secilit në platformat numerike.
3. Ligji nuk saktëson marrëdhëniet e aksesit dhe interkoneksionit midis operatorëve të platformave të ndryshme dhe midis operatorëve të platformave dhe atyre të programeve, operatorëve të shërbimeve, etj. Sot, të gjitha këto funksione kryhen nga të njëjtët subjekte, por me vendosjen e rregullave të një tregu normal, domosdoshmërisht do të realizohet profilizimi natyral i segmenteve të tregut, siç vërtetohet edhe nga eksperiencia e vendeve më të përparuara në Evropë e më gjerë.
4. Nuk është saktësuar baza ligjore për ofrimin e shërbimeve të aksesit të kondicionuar stipuluar në Konventën Europiane mbi mbrojtjen ligjore të Shërbimeve të bazuara në Aksesin e Kushtëzuar, Strasburg, 24.01.2001.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Shënim: Shqipëria nuk ka aderuar në këtë konventë

**5. Mungesa e një strategjie të miratuar për zhvillimin e perspektivën e transmetimeve numerike në Shqipëri**

Strategjia do të vendosë objektivat dhe rrugët për arritjen e tyre. Në këtë dokument, bazuar në kapacitetet e transmetimit të planifikuara për Shqipërinë, do të përcaktohet, p.sh, numri i rrjeteve publike dhe private në Republikën e Shqipërisë (kombëtare, rajonale dhe lokale), metodat e implementimit të tyre, financimet, sidomos financimet e ndërtimit të rrjetit të operatorit publik dhe një seri çështjesh të tjera, të cilat trajtohen me hollësi në dokumentin e Projektit të Strategjisë, tashmë të dorëzuar në institucionet vendimmarrëse.

**4.7.2.3 Standardet teknike të rrjeteve numerike**

Përcaktimi i standardeve teknike të rrjeteve numerike, përveç të tjerave, (sigurimi i cilësisë dhe stabilitetit të sistemit, etj) është i lidhur drejtpërdrejt edhe me përcaktimin e kapaciteteve transmetues të rrjetit.

Për këtë arsye, disa vende kanë përcaktuar me ligj standardet minimale teknike, duke siguruar që implementimi i rrjeteve numerike të realizohet bazuar në standardet më të përparuara.

Aktualisht, në tregun audiovizual ekzistojnë dy sisteme: DVB-T dhe DVB-T i përmirësuar. Të dy këta sisteme përdorin komprimimin MPEG 2 dhe MPEG 4, ku i dyti lejon një shfrytëzim shumë më efektiv të spektrit në krahasim me MPEG 2 duke rritur numrin e programeve të transmetuara nga një MUX (përfshirë programet HD).

Ndërkohë, kostoja për ndërtimin e rrjeteve dhe ajo e dekoderëve të sistemit MPEG 4 janë më të larta se të sistemit alternativ MPEG 2.

Duke marrë në konsideratë avantazhet që paraqet sistemi MPEG 4, në dokumentin e Strategjisë të paraqitur për miratim, propozohet që ky sistem të përcaktohet si sistemi i kodimit për ndërtimin e rrjeteve publike e private në territorin e Shqipërisë. (Për operatorët ekzistues që aktualisht ofrojnë të palicencuar rrjete bazuar në sistemin MPEG 2, mund të lihet një periudhë tranzicioni).

Në dokumentacionin teknik që u përgatit për garën për licencimin e operatorëve privatë kombëtarë, parashikohet që rrjetet të ndërtoheshin bazuar në sistemin MPEG 4, që u kundërshtua nga operatorët ekzistues të rrjeteve numerike.

#### *4.7.3. Një alternativë për përshpejtimin e implementimit të rrjeteve numerike tokësore*

Transmetimet numerike përbëjnë një realitet të prekshëm në Shqipëri qysh prej më se 4 vjetësh. Siç u përmend më sipër Digitalb, Supersport, por edhe TRING, janë të pranishëm në pothuaj gjithë territorin e vendit, nëpërmjet programeve të mbështetura qoftë në rrjete numerike tokësore, qoftë në rrjete satelitore. Këto programe ndiqen me interes nga pjesë të konsiderueshme të popullsisë, e cila është ambientuar me disa prej tyre sipas interesave të segmenteve e grupmoshave të ndryshme.

Natyrisht, përqendrimi i të gjitha aktiviteteve (ndërtimi e mirëmbajtja e rrjetit, ofrimi i shërbimeve dhe prodhimi e editimi i programeve) në dorën e një subjekti të vetëm, vështirëson veprimtarinë, ul efektivitetin dhe sidomos pengon hapjen e platformave numerike për ofrimin e programeve të pavarura nga operatori që zotëron rrjetin, në qoftë se nuk aplikohen rregullat e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

Ligji Nr.9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” (Neni 4, pika 1) përcakton:

*“Aplikuesit për licencë rrjeti, të pajisur ose jo me licencë për transmetim analog tokësor apo satelitor, që dëshirojnë të ndërtojnë një rrjet numerik, duhet të marrin pjesë në procesin e konkurrimit, të shpallur nga KKRT-ja, detajet e të cilit përcaktohen nga KKRT-ja, në përputhje me një rregullore, që miratohet paraprakisht për këtë qëllim”.*

Në kushtet kur operatorët aktualë operojnë pa licencë, një alternativë mund të ishte licencimi i tyre, pa aplikuar procedurën e konkurrimit të kandidaturave, mënyrë licencimi e përdorur në disa vende të BE-së (*beauty contest*). Kjo alternativë kërkon një amendim ligjor. Miratimi ose hedhja poshtë e kësaj alternative duhet të realizohet përmes organizimit të një debati të gjerë, i cili

duhet të zhvillohet në disa nivele, duke filluar nga konsultimi publik, tryeza me aktorë dhe faktorë të fushës e organizma të tjerë, duke përfunduar tek vendimmarrja nga autoritetet përkatëse.

Nëse, pas vendimmarrjes përkatëse, fiton versioni i licencimit sipas *beauty contest*-it, licencimi duhet të shoqërohet me disa kushte rigoroze për operatorët që do të përfitojnë, të cilat do të synojnë në sjelljen e tyre brenda kuadrit ligjor. Disa nga këto kushte mund të jenë:

1. Operatorët ekzistues do të lirojnë frekuencat e zëna arbitrarisht dhe do të migrojnë në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik, sipas specifikimeve të KKRT-së, brenda një kohe të përcaktuar në dokumentin e licencës;
2. Secili operator ekzistues do të licencohet për një rrjet kombëtar numerik. Kjo do të thotë që, për të rritur efektivitetin e shfrytëzimit të spektrit, për të transmetuar pjesën më të madhe të programeve që sot mbështeten në disa rrjete, të aplikohet sistemi i komprimimit MPEG-4, në vend të MPEG-2 që aplikohet sot. Edhe për këtë kalim, në dokumentin e licencës do të vendosen afate të përcaktuara kohore;
3. Në kushtet e licencës do të vendosen detyrime për mbështetjen e rrjeteve të operatorëve lokalë (facility sharing);
4. Në licencë do të vendosen kushte për të siguruar aksesin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën;
5. Në licencë do të vendosen kushte për standardizimin e sistemeve të aksesit të kufizuar, mbrojtjen nga programet me karakter dëmtues për të miturit, etj;
6. Në licencë, gjithashtu do të vendosen kushte për aplikimin e shërbimeve të reja (DVB-H, HD, etj) dhe interaktive.

Licencimi i transmetimeve ekzistuese numerike do të vendosë një bazë të fuqishme për realizimin e kalimit të shpejtë e të plotë në transmetimet numerike në Shqipëri, që do të përshpejtojë përfitimet nga dividendi numerik, që do të krijohet si pasojë e liritit të spektrit nga transmetimet analoge.

**V. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN**

**5.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative**

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe rritja e mëtejshme e performancës së administratës së KKRT-së, ka qenë dhe mbetet një objektiv i vazhdueshëm i punës së këtij institucioni, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e punonjësve që të përballojnë sfidat dhe proceset që diktohen nga zhvillimet teknologjike si dhe plotësimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e medias.

Parë në këtë aspekt, KKRT është përpjekur maksimalisht të krijojë një administratë efikase, të aftë për të përballuar dhe realizuar objektivat dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor aktual si dhe për të kryer me sukses hapat e mëdha që priten të realizohen në të ardhmen në kuadër të kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Më konkretisht, në zbatim të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.184, datë 19.05.2008, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të KKRT-së", me qëllim plotësimin e strukturës së KKRT-së, në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil, KKRT-ja ka organizuar konkurset me qëllim rekrutimin e punonjësve dhe emërimin e tyre në shërbimin civil, për të plotësuar në këtë mënyrë të gjithë organikën e institucionit.

Përfaqësues të KKRT-së, kanë qenë pjesëmarrës aktivë në trajnime dhe seminare të tjera të organizuara për probleme të ndryshme që lidhen me fushën e medias, përfshirë aspektet ligjore, administrative apo teknike të saj, duke mundur marrjen dhe shkëmbimin e përvojave konkrete në këtë drejtim.

Në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), për vitin 2009, u bë e mundur pjesëmarrja e punonjësve të KKRT-së në të gjitha trajnimet që ky Institut organizon për nëpunësit e administratës publike, duke bërë të mundur trajnimin e rreth 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin dhe menaxhimin e administratës publike, çështjet e integritimit evropian etj.

Pa mohuar arritjet e deritanishme, do të duhet të ritheksojmë përsëri se kalimi në sistemin numerik do të përbejë një nga sfidat madhore në fushën e medias, ndërkohë që burimet njerëzore dhe financiare mbeten të kufizuara për të përballuar këtë proces madhor.

Nevoja për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare, me qëllim realizimin e plotë dhe në kohë të atyre hapave që do të kërkonte kalimi në sistemin numerik, është theksuar në mënyrë të qartë edhe nga raporti i fundit i Komisionit Evropian, nëntor 2009, pika 2.2 si dhe nga Rekomandimet e dala nga Takimi i Nën-Komitetit BE-Shqipëri mbi zhvillimin e Teknologjisë, Shoqërisë së Informacionit dhe Politikat Sociale, të zhvilluar në Tiranë në nëntor 2009.

Forcimi i këtyre kapaciteteve nënkupton para së gjithash, forcimin e mëtejshëm të rolit rregullator të KKRT-së, në përputhje të plotë dhe me Rekomandimin nr. R (2000) 23, të Komitetit të Ministrave “Mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimeve” dhe Direktivën e Shërbimeve, të 11 dhjetorit 2007, (AVMSD).

Parë në këtë aspekt, në kuadër të hartimit të ligjit të ri në fushën e medias, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka paraqitur propozimet e tij, duke synuar forcimin e mëtejshëm të autoritetit rregullator. Miratimi i këtij ligji, do të duhet të pasohet me miratimin e ndryshimeve të nevojshme strukturore, me qëllim për t’ju përgjigjur nevojave për kapacitete të mjaftueshme administrative dhe teknike që do të kërkonte kalimi në sistemin numerik.

Siç është theksuar edhe më parë një problem shqetësues vazhdon të mbeten *kapacitetet e pamjaftueshme monitoruese të KKRT-së* “. Ky element ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm i shprehur nga KKRT-ja edhe në takimin e fundit të

zhvilluar në nëntor 2009, në Tiranë, me Komisionin Evropian, duke kërkuar mbështetjen e palës komunitare në këtë drejtim, nëpërmjet shfrytëzimit të instrumenteve financiare që Bashkimi Evropian ofron për Shqipërinë në kuadër të përshejtimit të reformave që kërkon procesi i integritit evropian.

Nisur nga ky aspekt, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit do të vazhdojë të punojë në këtë drejtim për të marrë mbështetjen e duhur financiare për realizimin e forcimit të kapaciteteve monitoruese, duke synuar monitorimin e plotë "On line" të programeve televizive në të gjithë territorin e Shqipërisë, ndërkohë që aktualisht ky monitorim mund të realizohet vetëm për operatorët radiotelevizivë, sinjali i të cilëve arrin në Tiranë.

Duhet të theksohet se, në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit, të nënshkruar më datë 23 prill 2009 ndërmjet Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e mediave elektronike gjatë fushatës së zgjedhjeve të qershorit 2009, u bë i mundur rinovimi i studios aktuale të monitorimit, gjë që siguroi shpejtësi dhe saktësi në nxjerrjen e të dhënave.

Gjithsesi, si një zgjidhje e plotë dhe përfundimtare në këtë drejtim do të konsiderohej krijimi i mundësive teknike për realizimin e kapaciteteve monitoruese "on line" në të gjithë territorin e vendit.

Një problem tjetër shqetësues, dhe që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mundësinë e realizimit të forcimit të kapaciteteve monitoruese, është pajisja me mjedise të reja pune të KKRT-së, të cilat mund t'i garantojnë institucionit një funksionim normal.

Me Vendimin nr.117, datë 23.07.2007 "Për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim, të një mjedisi në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit", Kuvendi vendosi dhënien e një godine në pronësi të RTSH për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar. Edhe Rezoluta "Për vlerësimin e veprimtarisë së RTSH për vitin 2007", e miratuar më 12 maj 2008, i kërkonte RTSH, ndërmjet të tjerash, " të lironte mjediset e duhura për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit ".

Pavarësisht këtyre veprimeve të ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë, fatkeqësisht ky problem nuk ka gjetur akoma rrugën e duhur të zgjidhjes. Për këtë arsye, do të insistonim dhe kërkonim përsëri mbështetjen e duhur për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, pasi realizimi i detyrimeve dhe objektivave që ka ky Institucion në të ardhmen, mund të cenoheshin seriozisht nga mungesa e kushteve normale të punës.

## 5.2. Marrëdhëniet me jashtë

KKRT tashmë ka konsoliduar bashkëpunimin me partnerët dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e medias. Edhe gjatë vitit raportues, ka vazhduar bashkëpunimi nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takimet e zhvilluara në nivel rajonal apo evropian që lidhen me zhvillimet dhe perspektivën në fushën e medias elektronike.

Sigurisht që, në kuadër të procesit të integritit evropian, kontaktet dhe takimet me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, mbeten parësore në funksion të njohjes me standardet dhe praktikat më të mira si dhe të plotësimit të rekomandimeve të parashtruara nga Komisioni Evropian për fushën e medias elektronike. Këto rekomandime kanë shërbyer për të njohur më mire problematikat e fushës, standardet që kërkohen të arrihen si dhe ndërmarrjen e hapave konkrete në realizimin e tyre.

Bashkëpunimi me OSBE-në vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm, nisur dhe nga kontributi që ky organizëm ka dhënë dhe vazhdon të japë në rrugën e zhvillimit të medias elektronike në Shqipëri, veçanërisht për sa i përket procesit të kalimit në sistemin numerik. Kjo mbështetje do të vazhdojë gjatë gjithë fazave të këtij procesi, si një garanci më shume për përfundimin me sukses të këtij kalimi.

Gjithashtu, KKRT-ja ka vendosur dhe forcuar bashkëpunimin me autoritetet rregullatore fqinje, të tilla si me Autoritetin Rregullator të Kosovës, Italisë, FYROM-it, Malit të Zi etj, në lidhje me çështje të ndryshme që lidhen me fushën e medias elektronike. Këtu duhet të përmendim në mënyrë të veçantë, takimin e zhvilluar me datë 3-5 dhjetor 2009 në Kosovë, në lidhje me

“Prezantimin e transmetimit dixhital në Kosovë dhe strategjitë rajonale”, ku morën pjesë përfaqësues të autoriteteve rregullatore të rajonit, përfshirë edhe përfaqësuesit e KKRT-së.

Përfaqësues të KKRT-së kanë marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë dhe takimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare në këtë fushë, si dhe në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tyre, të tilla si:

- EPRA (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore)
- ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit)
- RIRM (Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare)
- BSEC (Autoritetet Rregullatore të Vendeve të Detit të Zi)

### 5.3. Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit

Një sistem demokratik është më efikas kur publiku është i informuar për çështjet me interes të përbashkët. Transparenca e vazhdueshme e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit si dhe zhvillimi i një komunikimi të pandërprerë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, ka qenë dhe mbetet një objektivi primar i këtij institucioni.

Kjo mund të konstatohet në të gjithë aktivitetin dhe veprimtarinë e kryer nga KKRT, por në mënyrë të veçantë për sa i përket hartimit të projekt-strategjisë së kalimit në sistemin numerik, për të cilin është zhvilluar një proces i gjerë këshillimi publik me të gjithë aktorët e interesuar.

Ky proces këshillimi, i cili pati fazën e tij kulmore me zhvillimin me datë 22 shkurt 2009, të një Forumi Diskutimi me përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë dhe institucioneve të tjera shtetërore në lidhje me prezantimin e projekt-strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike dhe hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerren, do të vazhdojë më tej dhe nuk konsiderohet i përfunduar me miratimin e kësaj strategjie.

Gjithashtu, në kuadër të monitorimit të mediave elektronike gjatë fushatës së zgjedhjeve, KKRT miratoi vendimin “Për pasqyrimin ligjor, etik dhe

profesional të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009”, e cila iu drejtua në një formë kujtese të gjitha mediave elektronike në vend, duke synuar mirëkuptimin e operatorëve radiotelevizivë, në mënyrë që media elektronike të përmbushte përgjegjësitë e tyre ligjore për një pasqyrim të drejtë, të paanshëm dhe profesional të fushatës zgjedhore.

Faqja elektronike e KKRT-së mbetet një nga instrumentet e komunikimit të vazhdueshëm me publikun, e cila vazhdon të pasurohet dhe përmirësohet më tej si në formë dhe në përmbajtje, nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të saj, pasqyrimin sa më të saktë, të shpejtë dhe objektiv të gjithë veprimtarisë së KKRT-së, duke përfshirë në mënyrë të veçantë vendimet e marra nga KKRT në lidhje me veprimtarinë e subjekteve të ndryshme radio-televizive, si dhe marrjes së çdo informacioni apo këshille të dobishme nga publiku i gjerë si dhe nga operatorët radio-televizivë në lidhje me funksionimin më të mirë të saj.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka vendosur tashmë kontakte të përhershme me kategori të ndryshme shoqërore, përfshirë drejtuesit e mediave audiovizuale, analistët dhe gazetarët e shtypit elektronik dhe të shkruar, studentët etj, duke e bërë me efikas dhe transparent rolin që duhet të luajë ky institucion në raport me shtresa të ndryshme shoqërore dhe aktorët mediatik.

Forcimi i mëtejshëm i rolit të Këshillit të Etikës dhe marrëdhënive të tij me qytetarët, në funksion të ruajtjes së etikës në transmetimet audiovizuale, vazhdon të jetë një nga objektivat e punës të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. KKRT vazhdon të ketë si prioritet, në lidhje me këtë aspekt, etikën në programet televizive, respektimin e kodit etik, zbatimin e normës së gjuhës shqipe, të ruajtjes së dinjitetit dhe privatësisë së njeriut, të mbrojtjes së të miturve nga dhuna ose nga abuzimi etj.

Me vendimin nr.117, datë 23.07.2007 “Për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim, të një mjedisi në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”, Kuvendi vendosi dhënien e një godine në pronësi të RTSH për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar. Edhe Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së RTSH për vitin

2007", e miratuar më 12 maj 2008, i kërkonte RTSH, ndërmjet të tjerash, "të lironte mjediset e duhura për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit". Pavarësisht këtyre veprimeve të ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë, fatkeqësisht ky problem nuk ka gjetur akoma rrugën e duhur të zgjidhjes. Për këtë arsye, do të insistonim dhe kërkonim përsëri mbështetjen e duhur për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, pasi realizimi i detyrimeve dhe objektivave që ka institucioni ynë në të ardhmen, mund të cenoheshin seriozisht nga mungesa e kushteve normale të punës.

**VI. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË**

**6.1 Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve**

Përlllogaritja e detyrimeve financiare të pagesave vjetore për licencë dhe të taksave për shërbimet RTV për operatorët aktivë të licencuar, mbi bazën e treguesve analitikë të numrit të popullsisë së zonave të licencimit, numrit të transmetuesve të operatorëve dhe fuqisë së rrezatimit të tyre, është burimi bazë i të dhënave për hartimin e buxhetit të Institucionit në treguesin kryesor financiar – Të Ardhura.

Pas Vendimit nr.173 të Këshillit të Ministrave, datë 19.2.2009, "Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2009", KKRT, me Vendimin nr. 791, datë 27.03.2009, miratoi buxhetin vjetor të administratës së KKRT në limite, Të Ardhura e Shpenzime. Treguesit financiarë për vitin 2009, janë miratuar sipas struktures, si më poshtë:

Në milion lekë

Të ardhura të krijuara në vitin 2009	142.2
Te ardhura per t'u trashëguar vitin e ardhshem	- 11.7
Shpenzime korente	75.5
Shpenzime për Investime	55

6.1.1 Realizimi i treguesve financiarë – TË ARDHURAT

Struktura e zërit “Të Ardhura” e parashikuar dhe e realizuar për vitin 2009, paraqitet:

Nr	Zërat e të ardhurave	Në mln lekë	
		Plani vjetor	Realizimi Viti 2009
1	Të ardhura nga pagesa për licencë nga operatorët analogë tokësorë e kabllorë dhe të rrjeteve numerike tokësore kombëtare	93.50	52.49
	Nga këto:		
	a) Pagesa për licencë nga operatorët analogë tokësorë e kabllorë	48.50	33.74
	b) Pagesa për licencë nga operatorët e rrjeteve numerike tokësore kombëtare	45.0	0
	c) Pagesa për licencë nga operatorët e platformës numerike kombëtare satelitore	0	18.75
2	Të ardhura nga pagesa për marrjen e licencës nga operatorët e rrjeteve numerike tokësore kombëtare	45.0	0
3	Të ardhura nga përpunimi i dokumenteve të licencës	1.20	2.04
4	Të ardhura nga përfitimet si agjent tatimor	1.20	0.94
5	Të ardhura nga interesa bankare për depozitat në bankë	1.20	1.80
6	Të ardhura të tjera	0.10	0.09
7	Te ardhura te arketuara nga detyrimet e viteve te kaluara		7.46
	<b>Gjithsej Të ardhura</b>	<b>142.2</b>	<b>64.82</b>

Gjatë vitit 2009, janë realizuar të ardhura vjetore në shumën prej 57.36 milion lekë. Peshën specifike më të madhe rreth 52.49 milion lekë ose 91.5 %, e zënë të ardhurat nga shlyerja e detyrimeve financiare të pagesave vjetore për licencë të operatorëve RTV si dhe nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave. Gjithashtu janë arkëtuar në vitin 2009, 7.46 milion lekë të ardhura, të parashikuara dhe të porealizuara në vitin 2008. Si rrjedhojë, Të ardhura të arkëtuar në vitin 2009 janë **64.82 milion lekë**

Me Vendimin nr. 726, datë 8.09.2008 KKRT shpalli të hapur garën për rrjetet numerike kombëtare. Si rrjedhojë, në buxhetin e vitit 2009 u parashikuan të


ardhurat nga pagesat vjetore për licencë dhe pagesat për marrjen e licencës për rrjetet numerike kombëtare.

Për arsyen se kjo garë është ngrirë dhe do të rifillojë në vitin 2010, ky tregues nuk është realizuar sipas buxhetit të parashikuar dhe të miratuar. Shuma e të ardhurave nga operatorët e rrjeteve numerike tokësore kombëtare u parashikua 90 milion lekë, 45 milion lekë si pagesë vjetore për licencë dhe 45 milion lekë si pagesë për marrjen e licencës (për tre operatorë). Mosrealizimi i këtij treguesi ka ndikuar në përqindjen e ulët të realizimit të të ardhurave të vitit 2009, rreth 40.3%.


Vendimi nr. 786, datë 25.02.2009 i KKRT-se ka licencuar tre operatorë duke i autorizuar të funksionojnë si platformë numerike kombëtare satelitore.

Të ardhurat nga pagesat për licencë për platformën numerike kombëtare satelitore nuk ishin pjesë e buxhetit të parashikuar dhe të miratuar për vitin 2009. Ato janë realizuar në shumën prej 18.75 milion lekë, ose 83.3% në krahasim me shumën prej 22.5 milion lekë (Pagesa vjetore për licencë 11.25 milion lekë, pagesa për marrjen e licencës për platformën numerike 11.25 milion lekë).

Në fushën e mediave elektronike për vitin 2009, kanë qënë aktivë 208 operatorë, të klasifikuar sipas llojit të aktivitetit si më poshtë:



Të ardhurat e realizuara nga pagesat për licencë pasqyrohen në grafikun vijues:



Krahasuar me nivelet e të ardhurave të planifikuara, realizimi i Të ardhurave nga pagesat për licencë arrin në rreth 69 %. i detajuar, realizimi nga operatorët radio është 81.2 % , nga operatorët TV me frekuencë 58.6 %, nga operatorët TV kabllorë me 63.4 % dhe nga operatorët e platformës numerike satelitore 83.3 %.

Pagesa vjetore e licencës, diferenca nga viti 2008 është në shumën 7.45 milion lekë. Pagesat e mbartura nga viti paraardhës krijohen pasi pagesa vjetore për licencë e cila llogaritet për vit licencimi, mund të faturohet në vitin paraardhës por paguhet në vitin pasardhës. Një shkak tjetër është neglizhenca e operatorëve për shlyerjen në afat të detyrimeve. Për penalizimin e këtyre rasteve operatorët merren në konsideratë nga KKRT, duke marrë masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës.

*Të ardhurat nga agjenti tatimor – Taksat për shërbimet RTV paqyrohen si vijon:*

Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” ngarkon KKRT, në rolin e agjentit tatimor, për transferimin në buxhetin e shtetit të taksës vjetore për shërbimet RTV të subjekteve. Për këtë shërbim, KKRT përfiton 5 përqind të vlerës së arketuar dhe të transferuar në buxhetin e shtetit.

Për vitin 2009 janë transferuar në buxhetin e shtetit rreth 18 milion lekë, nga të cilat 15.6 milion lekë taksa për shërbimet RTV detyrime të vitit 2009 dhe 2.4 milion lekë detyrime të viteve të kaluara. Nga KKRT, si agjent tatimor janë përfituar rreth 0.93 milion lekë.

Të ardhurat nga interesat bankare për fondet e depozituara në bankë për periudhën Janar – Dhjetor 2009 janë rreth 1.8 milion lekë.

### 6.1.2 Realizimi i treguesve financiarë - SHPENZIMET

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 173 datë 19.2.2009, "Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2009", miratoi fondin limit të shpenzimeve për këtë vit të detajuar si më poshtë:

Shpenzime korente	75.5
Shpenzime për investime	55.0
<b>Gjithsej</b>	<b>130.5</b>

Për periudhën Janar – Dhjetor 2009 realizimi i shpenzimeve sipas strukturës paraqitet:


Mln lekë

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime korente (operative)	75.5	68.4	90.5
	a) Paga e kontribute	52	48.4	93
	b) Shpenzime materiale e të tjera	23.5	20	85.1
2.	Shpenzime për investime	55	3.5	6.3
	a) Blerje pajisje zyre, pajisje operacionale specifike e softë informatike	5.2	0.73	14
	b) Shpenzime për transferimin e frekuencave	33.8	0	0
	c) Qendra e monitorimit në distancë	16	2.73	1.7

*Shpenzime korente*

Shpenzimet operative janë realizuar në masën prej 68.42 milion lekë ose 90.5% e shumës së planifikuar. Realizimi në këtë masë ka ardhur për arsye se:

- Realizimi i zërit “Paga e kontribute të tjera” në masën prej 93% ka ardhur si rrjedhojë e largimit të disa punonjësve gjatë vitit 2009 dhe plotësimit të organikës pas pak muajve.
- Gjatë vitit 2009, Shpenzimet për honorare janë realizuar në masën 1.81 milionë lekë ose 60%, për arsyen e mosfunksionimit të Këshillit të Etikës gjatë këtij viti. Gjithashtu, shtyrja e tenderit për ruajtjen e godinës solli mos realizimin e shpenzimeve për këtë zë.



*Shpenzimet për investime*

Ky tregues është realizuar në masën 3.46 milion lekë ose 6.3% ndikuar nga dy faktorë.

Së pari, ngadalësimi i procesit të kalimit të operatorëve nga analogë në numerikë ndikoi drejtpërdrejt në mosrealizimin e shpenzimeve për transferimin e frekuencave analoge në numerike, të cilat ishin parashikuar në masën prej 33.8 milion lekë. Në vitin 2009 vetëm një operator analog televiziv ka kaluar në transmetimin numerik.

Së dyti, për ngritjen e qendrës së monitorimit të programeve, u bë testimi i tregut për çmimet për pajisjet elektronike sipas specifikimeve teknike përkatëse. Mbi këtë bazë u përcaktua fondi limit në masën prej 4.1 milion lekë me TVSh.


Si rezultat i veprimtarisë ekonomike për vitin 2009, në llogarinë bankare të institucionit në datën 28.01.2010 rezultojnë gjëndja likuide 52.06 milion lekë.

## 6.2 Pasqyrat financiare të operatorëve RTV


Në zbatim të nenit nr. 48 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, KKRT ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë të cilët kanë patur aktivitet për vitin 2008, të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të vitit 2008, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin, të vulosur e sigluar nga drejtoritë e tatimeve në rrethe.

Në mbyllje të vitit 2009, nga 170 operatorë të cilët kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2008, 88 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2008 ose 52 % e operatorëve. Nga këta, kanë depozituar pasqyrat financiare 32 operatorë radio ose 66%, 36 operatorë TV ose 50%, 20 operatorë TV me kabëll ose 40%. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezultojnë 16 me humbje ose 18 % , 5 operatorë ose 6% ka rezultat financiar zero, ndërsa 67 ose 76% janë me rezultat financiar pozitiv.

Të ardhurat gjithsej të rezultuara nga pasqyrat financiare të dorëzuara për vitin 2008, në mbyllje të vitit 2009 janë në shumën 2 475 milion lekë, me rritje prej 763 milion lekë në krahasim me vitin 2007.



Treguesi “Të ardhurat nga reklamat” zë peshën specifike kryesore të Të ardhurave gjithsej, ose 58%. Në vitin 2008 në krahasim me vitin e mëparshëm treguesi të ardhurat nga reklamat ka rënie prej rreth 8.5%.



### 6.3. Realizime të Tjera

#### 6.3.1 Dhurimet

Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8410, KKRT-ja mund të përfitojë edhe nga dhurimet financiare ose materiale. Dhurimet janë pranuar pa kushte dhe janë përdorur për nevojat e punës sipas vlerësimit të KKRT-së. Dhurimet janë shënuar në regjistrin e mbajtur posaçërisht për këtë qëllim. Në fund të vitit 2009, janë njoftuar Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Shuma e përfituar nga dhurimet në vitin 2009 është 280 mijë lekë.

#### 6.3.2 Gjobat

Neni 137 i ligjit nr. 8410, i jep të drejtën KKRT të vendosë sanksione administrative për shkeljen e dispozitave detyruese të ligjit. Gjatë vitit 2009, janë vendosur 45 sanksione – gjoba në vlerën 11.7 milion lekë. Janë vjelë dhe transferuar në buxhetin e shtetit 1.87 milion lekë. Për ekzekutimin e vendimeve lidhur me gjobat, KKRT ka bashkëpunuar me Policinë Tatimore.

### *6.3.3. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*

Në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", të Udhëzimit nr. 36, datë 11.11.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimeve e transmetimeve radiotelevizive" dhe të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit" nr. 299, datë 20.03.2007, KKRT ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për ekzekutimin e vendimeve dhe urdhrave të KKRT për sanksionet e vëna dhe për vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga subjektet radiotelevizive.

Pavarësisht korespondencës shkresore me DPTatimeve, shlyerja e detyrimeve të taksave për shërbimet radiotelevizive nga subjektet në masën 69.4 % për vitin 2009, ekzistenca e llogarisë "Debitorë të prapambetur", vjelja e sanksioneve – gjobë vetëm nga 29 % e subjekteve, flasin për bashkëpunim jo funksional me këtë Institucion.

### *6.3.4. Rezultatet dhe rekomandimet e kontrollit të ushtruar nga KLSH*

Nga kontrolli i ushtruar nga Grupi i Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit" për periudhën 1.08.2006 deri 31.10.2008, rezultoi se KKRT e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare, duke zbatuar Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave krahas legjislacionit specifik në fushën e mediave elektronike.

Në raportin përfundimtar, të dërguar në KKRT në mars 2009, u lanë rekomandime për disa masa organizative në lidhje me nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit dhe ndjekjen në rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimeve financiare të operatorëve dhe mbyllja e llogarise "debitorë të prapambetur"; për rinovimin e kontratës me ndërmarjen e Ujësjetës Kanalizime; për shfuqizimin e urdhërit të brendshëm ekzistues dhe marrjen e masave për disiplinimin dhe menaxhimin sipas akteve ligjore në fuqi të shpenzimeve të karburantit; për mbylljen e menjëhershme të paradhënieve për shërbimet.

Të gjitha rekomandimet e lëna si më lart, janë zbatuar nga KKRT dhe masat orgaizative të marra në zbatim të tyre janë referuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 33/3, datë 07.04.2009.

#### *6.3.5. Të tjera*

Gjatë vitit 2009 është punuar për përmirësimet e projekt akteve normative, në lidhje me problemet ekonomike, janë rishikuar e përmirësuar biznes-planet ekonomike, janë ndjekur në mënyrë operative detyrimet financiare të operatorëve për respektimin e afateve ligjore të shlyerjes së detyrimeve.

Përdorimi elektronik i të dhënave të Tatim-Taksave dhe të Sigurimeve shoqërore, ka rritur nivelin e shfrytëzimit të informacionit financiar dhe efikasitetin e tij.

## VII. KONKLUZIONE

Në mbyllje të këtij Raporti Vjetor do të theksonim si më thelbësore konkluzionet e mëposhtme:

- Përsheptimi i hapave për miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, duhet të trajtohet me prioritetin maksimal. Në këtë aspekt, Komiteti Ad-Hoc për Strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm që kërkohen për miratimin e këtij dokumenti strategjik. Duke pasur parasysh që brenda vitit 2012, ky proces duhet të përfundojë, është një arsye më shumë për nevojën e veprimeve të shpejta dhe konkrete që duhet të realizohen në këtë drejtim.
- Përfundimi i reformës ligjore, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian është një tjetër hap madhor që duhet të realizohet në një periudhë sa më të shpejtë kohore. Kjo reformë duhet të jete e mirekoordinuar me strategjinë dhe duhet të jete produkt i objektivave që do të parashikojë Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale.
- Nevoja e forcimit të kapaciteteve administrative dhe financiare të KKRT, do të duhet të shihet me përparësi, duke pasur në konsideratë edhe procesin e vështirë të kalimit nga sistemi analog në atë numerik. Miratimi i ligjit të ri të medias audiovizuale, domosdoshmërisht duhet të shoqërohet me një strukturë më efektive të KKRT-së, për t'iu përshtatur më mirë zhvillimeve në fushën e medias elektronike.
- Nevoja e përmirësimit të infrastrukturës së punës dhe kapaciteteve monitoruese të KKRT-së mbetet një tjetër problematikë e përsëritur që kërkon një zgjidhje të shpejtë. Pajisja e KKRT-së me mjedise të reja pune mbetet themelore për funksionimin normal të institucioni, shqetësim i cili akoma nuk ka gjetur rrugën e zgjidhjes. Përmirësimi i infrastrukturës së punës do të krijonte mundësinë e përmirësimit edhe

të kapaciteteve monitoruese të KKRT-së, përfshirë krijimin e mundësisë së monitorimit në distancë.

- Licencimi i operatorëve numerike tokësorë (si atyre ekzistues, ashtu edhe subjekteve të rinj që do të futen në tregun e transmetimeve numerike), do të ishte një arritje e rëndësishme në liberalizimin e tregut, respektimin e konkurrencës dhe ofrimin e zgjedhjes për konsumatorët.
- Krahas rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit për vlerësimin e normave etike dhe morale në programet radiotelevizive do të përdoren forma të reja të bashkëpunimit me operatorët, në gjetjen e hapësirave për sistemin e vetërregullimit, efikasitetin dhe funksionimin racional të këshillave etike të operatorëve radiotelevizivë. Përparësi në këtë fushë do të ketë veprimtaria e Këshillit të Etikës pranë KKRT-së, aplikimi i formave të reja të monitorimit për respektimin e parimeve etike, kërkesave dhe normave morale e ligjore për mbrojtjen e fëmijëve.
- Zbatimi me rigorozitet i akteve normative në fuqi për sigurimin e vjeljes së detyrimeve financiare të pagesave vjetore për licencë.
- Bashkëpunimi efikas me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vjeljen e detyrimeve financiare të taksave për shërbimet radiotelevizive.
- Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me Policinë Tatimore dhe Policinë e Shtetit për vjeljen e detyrimeve të prapambetura të operatorëve të cilëve i'u është hequr licenca, mbyllja e llogarisë "Debitorë".

VIII. ANEKSET

ANEKSI I

PASQYRA E GJOBAVE PER VITIN 2009

Nr	Subjekti	Numri	Data	Shkaku	Shuma
1.	TV Kabllor Lissus	0183	09.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 813, dt. 24.04.2009 (Paguar)
2.	TV Kabllor Multivizion	0184	09.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 815, dt. 24.04.2009 (Paguar)
3.	TV Kabllor Lushnja	0185	09.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 814, dt. 24.04.2009 (Paguar)
4.	TV Kabllor Memaliaj	0186	19.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 817, dt. 24.04.2009 ankuar në Gjykatë, fituar nga KKRT
5.	TV Kabllor Tepelena	0187	19.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 816, dt. 24.04.2009
6.	TV Kabllor Egnatia	0188	30.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 818, dt. 24.04.2009 (Paguar)
7.	TV Kabllor Permeti	0189	31.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë
8.	TV Kabllor Alfa	0190	30.03.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 819, dt. 24.04.2009

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

9.	TV Kabllor Delvina	0191	08.04.2009	neni 40/1 dhe 137/4 pika 7	200.000 lekë (Paguara)
10.	TV Kabllor Lezha	0192	03.06.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë hequr me v. 871, dt. 30.07.2009
11.	TV ALB- Ëest	0193	29.07.2009	neni 137/4, pika 2/a <sup>5</sup>	200.000 lekë hequr me v. 876, dt. 13.08.2009
12.	TV Kabllor Bulqiza	0194	07.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 886, dt. 06.11.2009
13.	TV Kabllor Dushk	0195	07.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 888, dt. 06.11.2009
14.	TV Kabllor Permeti	0196	07.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë
15.	TV Kabllor JUG	0197	12.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	500.000 lekë Lënë në fuqi me v. 884, dt. 06.11.2009
16.	TV Kabllor AVN	0198	12.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	500.000 lekë Lënë në fuqi me v. 885, dt. 06.11.2009
17.	TV SCAN	0199	12.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë (Paguara)
18.	TV Kabllor Elbasat	0200	13.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë (Paguara)
19.	TV Kabllor Lissus	0201	20.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë
20.	TV Kabllor Orikum	0202	20.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë

<sup>5</sup> Mosrespektim i kufijve kohorë dhe territorialë të kushteve të licencës

**KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT**

21.	Z. Ethem Ballesha	0203	20.10.2009	neni 137/4, pika 4 <sup>6</sup>	50.000 lekë
22.	Z. Sadrit Danaj	0204	20.10.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
23.	TV Kabllor Lezha	0205	21.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 887, dt. 06.11.2009
24.	TV Kabllor JUG (e dyta)	0206	23.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	600.000 lekë Lënë në fuqi me v. 884, dt. 06.11.2009
25.	Tring	0207	27.10.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 893, dt. 14.12.2009
26.	TV Kabllor Delta	0208	03.11.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Sanksioni i paralajmërimit me v. 893, dt. 14.12.2009
27.	TV Kabllor Fraholli	0209	03.11.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 896, dt. 14.12.2009
28.	TV Kabllor Hudenisht	0210	03.11.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë Lënë në fuqi me v. 895, dt. 14.12.2009 (Paguar)
29.	Z. Shaban Merkaj	0211	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	20.000 lekë
30.	Z. Arben Xhambazi	0212	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
31.	Z. Bajram Skrraqi	0213	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
32.	Z. Festo Cake	0214	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
33.	Z. Misir Dyrmo	0215	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë (Paguar)
34.	Z. Edmond Zane	0216	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë (Paguar)
35.	Z. Robert	0217	06.11.2009	neni 137/4,	50.000 lekë

<sup>6</sup> Dalje në trans. pa licencimin e KKRT-së.

**KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT**

	Prendi			pika 4	(Paguara)
36.	Z. Gezim Kasmellari	0218	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	20.000 lekë
37.	Z. Fredi Hasa	0219	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	20.000 lekë (Paguara)
38.	Z. Fredi Ziu	0220	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
39.	Z. Geront Sevrani	0221	06.11.2009	neni 137/4, pika 4	50.000 lekë
40.	TV Kabllor Roskovec	0222	13.11.2009	neni 137/4, pika 2/dh <sup>7</sup>	100.000 lekë
41.	TV Kabllor Butrinti (Tefik Abdullai)	0223	09.12.2009	neni 137/4, pika 4	1.000.000 lekë
42.	Tring	0224	10.12.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	1.000.000 lekë
43.	Tring	0225	16.12.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	1.000.000 lekë
44.	Radio Rash	0226	22.12.2009	neni 137/4, pika 2/d <sup>8</sup>	100.000 lekë (Paguara)
45.	Radio House of Art's	0227	28.12.2009	neni 137/4, pika 4	1.000.000 lekë
46.	Tring	0228	30.12.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	1.000.000 lekë
47.	Digitalb	0229	30.12.2009	neni 137/4, pika 7 dhe neni 40/1	200.000 lekë

<sup>7</sup> Ndalimi inspektorëve për të ushtruar kontroll

<sup>8</sup> Mosnjofitim të ndryshimeve

ANEKSI II

Lista e Urdhrave për subjektet Debitorë.

1. Urdhri nr. 38, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Radio-Tv Argjiropolis" sh.p.k.
2. Urdhri nr. 39, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Mentor Roçi".
3. Urdhri nr. 40, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Isuf Heba".
4. Urdhri nr. 41, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Sajmir Bagosi".
5. Urdhri nr. 42, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit RTSH".
6. Urdhri nr. 43, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Bardhyl Tosku".
7. Urdhri nr. 44, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Neë Planet Radio" sh.p.k.
8. Urdhri nr. 45, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Real Tv" sha.
9. Urdhri nr. 46, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Johaniter" sh.a.
10. Urdhri nr. 47, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Shoqata Iliriada".
11. Urdhri nr. 48, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Eduart Goci".
12. Urdhëri nr. 49, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Calvin Vizion" sh.a.
13. Urdhri nr. 50, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Isaku" sh.p.k.
14. Urdhri nr. 51, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "KTV1" sh.a.
15. Urdhri nr. 52, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Frano Kulli".

16. Urdhri nr. 53, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit privat fizik z. Simon Gjondrekaj".
17. Urdhri nr. 54, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Alba TV" sh.a.
18. Urdhri nr. 55, datë 13.05.2009 "Për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjektit "Cable Netëork Albania" sh.p.k.

ANEKSI III

A Çështjet gjyqësore që aktualisht janë në gjykim:

*Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë duke u gjykuar 4 çështje*

1. Media Vizion sh.a. (Vizion +) – KKRT me objekt – pavlefshmëria absolute e Vendimit nr. 631, datë 08.10.2007 të KKRT-së, heqja e masës së sekuestros dhe kthim të sendeve, pajisjeve të bllokuara nëpërmjet këtij vendimi; marrja e masës së sigurimit të padisë, për pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 4128, datë 05.05.2008 u vendos rrëzimi i kërkesë-padisë si e pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse u bë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 1372, datë 29.10.2009 vendosi kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues.
2. RTSH – Media 6 me objekt – shlyerje detyrimi kontraktor. KKRT është thirrur nga gjykata si palë e tretë në këtë gjykim.
3. RTSH – Media 99 me objekt – shlyerje detyrimi kontraktor. KKRT është thirrur nga gjykata si palë e tretë në këtë gjykim.
4. TV Kabllor Memaliaj – KKRT me objekt – shfuqizimin e Vendimit nr. 0186, datë 19.03.2009 Grupi të Inspektimit të KKRT-së dhe të Vendimit nr. 817, datë 24.04.2009 të KKRT-së duke anuluar gjobën në shumën 200 000 lekë.

*Në Gjykatën e Apelit Tiranë janë duke u gjykuar 8 çështje*

1. Majlinda Alimehmeti – KKRT me objekt – deklarimi i pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës, lidhur midis palëve ndërgjyqëse, pagimi i një shpërblimi për 12 paga. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin e saj nr. 5636, datë 17.06.2008 vendosi pranimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afateve ligjore.

2. TV Johaniter – KKRT me objekt – anulimin e Vendimit nr. 660, datë 18.12. 2007 i KKRT-së "Për heqjen e licencës së TV Johaniter, Tiranë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin e saj nr. 8565, datë 10.10.2008 vendosi pranimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afateve ligjore.
3. Radio Koha – KKRT me objekt – shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 537, datë 20.11.2006 të KKRT-së, "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës dhe miratimin e masës së gjobës të vendosur ndaj subjektit "Radio Koha", pezullimin e menjëhershëm të aktit administrative dhe Radio Koha – KKRT me objekt – shfuqizimin e vendimit të KKRT-së, për shpalljen e njoftimit publik për hapjen e garës për radio lokale në frekuencën 98.1MHZ, pronë e Radio Koha; pezullimin e menjëhershëm të aktit administrativ. Këto dy çështje civile u bashkuan dhe po gjykohen së bashku. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin e saj nr. 4200, datë 18.05.2009 vendosi pranimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afateve ligjore.
4. Anjeza Mio – KKRT me objekt – detyrimi i Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit për dhënien e dëmshpërblimit prej 15 paga mujore. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 2757, datë 07.04.2009 vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afateve ligjore.
5. Neës 24 – KKRT me objekt – anulimin e akteve administrative, vendimit nr. 181, datë 02.09.2008 të Grupit të Inspektimit të KKRT-së si dhe të vendimit nr. 727, datë 24.09.2008 të KKRT-së. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 10007, datë 02.12.2009 vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afateve ligjore.
6. Neë Planet Radio – KKRT me objekt – anulimin e vendimit nr. 625, datë 01.10.2007 të KKRT-së Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 5097, datë 11.06.2009 vendosi rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi nga ana e paditësit është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

7. KKRT – Pandi Kasapi me objekt – kundërshtimi i vendimit me nr. 37, datë 21.07.2009 të Komisionit të Shërbimit Civil Tiranë.
8. Media + sh.a (TV Shijak) – KKRT me objekt – detyrim për shpërblim dëmi në shumën 143.603.288 lekë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më datë 21.12.2009 vendosi rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi nga ana e paditësit është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

*Në Gjykatën e Apelit Vlorë janë duke u gjykuar 2 çështje*

1. TV AVN (kabllor) – KKRT me objekt – ankim kundër vendimit nr. 527, datë 13.11.2006 të KKRT-së (lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0140, datë 02.10.2006 në masën 1.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1070, datë 04.07.2007 vendosi pranimin e padisë së TV AVN, duke anuluar vendimin nr. 527, datë 13.11.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 20.07.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit, Vlorë.
2. TV AVN (kabllor) – KKRT me objekt – ankim kundër vendimit nr. 514, datë 09.10.2006 të KKRT-së (lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0137, datë 28.09.2006 në masën 800.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1101, datë 10.07.2007 vendosi pranimin e padisë së TV AVN, duke anuluar vendimin nr. 514, datë 09.10.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 04.09.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

*Në Gjykatën e Lartë janë duke u gjykuar 7 çështje*

1. TV BBF – KKRT me objekt – shfuqizimin e vendimit nr. 549, datë 28.12.2006 të KKRT-së ; pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin e saj nr. 2374, datë 03.04.2007 vendosi pranimin e padisë së

Shoqërisë "BBF" sh.a, duke anuluar vendimet nr. 536, date 20.11.2006 dhe nr. 549, date 28.12.2006 të KKRT-së si të pavlefshëm dhe detyrimin e të paditurit për të rinovuar licencën e paditësit, si dhe pezullimin e pasojave të këtyre akteve administrative të sipërcituara derisa ky vendim gjyqësor të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 17.04.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë me vendimin e saj nr. 590, datë 20.03.2008 vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 2374, datë 03.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. KKRT nuk kishte dijeni për këtë seancë dhe nuk morëm pjesë. Avokatura e Shtetit, e cila ishte prezent ushtroi rekurs në Gjykatën e Lartë në datën 14.04.2008.

2. TV AVN (kabllor) – KKRT me objekt – ankim kundër vendimit nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0098, datë 03.11.2004 në masën 800.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1503, datë 14.11.2005 kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkesë-padisë, anulimin e gjobës datë 03.11.2004 të grupit të inspektimit të KKRT-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj të datës 30.05.2006 vendosi të kthejë për rigjykim dosjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në rigjykim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 217, datë 07.02.2007 kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkesë-padisë, anulimin e gjobës datë 03.11.2004 të grupit të inspektimit të KKRT-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së. Kundër vendimit nr. 217, datë 07.02.2007 nga ana e KKRT-së në datën 23.02.2007 është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 206, datë 13.06.2008 pas 3 seancave të gjykimit të kësaj çështje vendosi të ndryshojë vendimin nr. 217, datë 07.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të rrëzojë kërkesë-padinë. Nga ana e paditësit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. (fituar)
3. Radio Stinët – KKRT me objekt – anulimin e aktit administrativ nr. 416, datë 28.02.2006 të KKRT-së si akt i pavlefshëm (Lidhur me heqjen e licencës së radio Stinët). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 2635, datë 12.04.2007, vendosi rrëzimin e padisë së Shoqërisë "Stinët" sh.p.k., duke lënë në fuqi vendimin nr. 416, datë 28.02.2006 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse

është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Apelit Tiranë në datën 03.04.2008 dhe me vendimin e saj nr. 694, kjo gjykatë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e paditësit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. (fituar)

4. Nertila Kellici – KKRT me objekt – Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë me pagën e një viti për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; - Të më paguajë me 2 muaj pagë për moszbatim të afateve të njoftimit; - Të më paguajë me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; - Pagimin e 3 ditëve pune të papaguara, pagimin e shpërblimit në mënyrë përpjesëtimore të kohës së punës për vitin 2006, si dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 3845, datë 22.05.2007, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë; - Detyrimin e të paditurit KKRT-ja të dëmshpërblejë paditësen Nertila Kelliçi në masën e pagës së 8 (tetë) muajve punë, për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; - Detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditëses pagën e 2 (dy) muajve, për mosrespektimin e afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës; - Detyrimin e te paditurit për të dëmshpërblyer paditësen në masën e pagës së 2 (dy) muajve, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; - Detyrimin e të paditurit të paguajë shpenzimet gjyqësore në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata; - Rrëzimin e kërkesë-padisë në pjesët e tjera të saj si të pabazuar në prova e në ligj. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së në datën 06.06.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Apelit Tiranë në datën 17.06.2008 dhe me vendimin e saj nr. , kjo gjykatë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, në bazë të kërkesës sonë për pezullim të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, Gjykata e Lartë ka vendosur me vendimin nr. 394, datë 07.11.2008, pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3845, datë 22.05.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. “Albautor” – KKRT me objekt – shpërblim për çdo licencë të dhënë operatorëve radiotelevizivë, pa autorizimin e Albautor (d.m.th. që KKRT ta shpërblejë për çdo licencë të dhënë operatorëve

radiotelevizivë në shumën 50.000 lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5586, datë 13.07.2007 vendosi të rrëzojë padinë e palës paditëse “Albautor” si të pambështetur në ligj dhe në prova. Nga ana e palës paditëse u depozitua kërkesa-ankimore për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Apelit Tiranë në datën 05.12.2008 dhe me vendimin e saj nr. 1958, kjo gjykatë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e paditësit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. (fituar)

6. TV Arbëria – KKRT me objekt – anulimin e vendimit nr. 567, datë 21.02.2007 të KKRT-së për reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 6441, datë 01.10.2007 vendosi pranimin e kërkesë - padisë së Shoqërisë “Televizioni Arbëria” sh.a, duke anuluar vendimin nr. 567, datë 21.02.2007 të KKRT-së. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Apelit Tiranë në datën 06.11.2008 dhe me vendimin e saj nr. 1781, kjo gjykatë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e Avokaturës së Shtetit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.
7. Sefedin Çela – Kuvendi i Shqipërisë; KKRT me objekt – kërkohet dëmshpërblimi, për shkak të ndërprerjes së mandatit të anëtarit të KKRT-së pa shkaqe të arsyeshme; dhënia e këtij vendimi me ekzekutim të përkohshëm. KKRT është thirrur në këtë çështje si person i tretë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj 7697, datë 07.11.2007 vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesë-padisë së Z. Sefedin Çela, duke vendosur detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë t’i paguajë paditësit Sefedin Çela pagën e 3 (tre) viteve punë në masën 1.620.000 (një milion e gjashtëqind e njëzetë mijë) lekë. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. 88, datë 30.01.2009 vendosi ndryshimin e vendimit nr. 7697, datë 07.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur detyrimin e KKRT-së t’i paguajë paditësit Sefedin Çela shpërblim për 14 muaj. Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

*B Çështje gjyqësore të përfunduara (7):*

1. TV AVN (kabllo) – KKRT me objekt – ankim kundër vendimit nr. 513, datë 09.10.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0136, datë 25.09.2006 në masën 500.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e saj nr. 1051, datë 02.07.2007 vendosi rrëzimin e padisë së TV AVN, duke lënë në fuqi vendimin nr. 513, datë 09.10.2006 të KKRT-së. Nga ana e palës paditëse u depozitua kërkesa-ankimore për në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj të datës 10.04.2009 vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 1051, datë 02.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. (fituar)
2. TV A1 (Ballkan) – KKRT me objekt – ankim kundër vendimit nr. 508, datë 29.09.2006 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0123, datë 09.05.2006 në masën 2.000.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së për dalje në transmetim pa autorizim në sistemin numerik). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7581, datë 05.11.2007 vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse u bë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj të datës 27.02.2009 vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 7581, datë 05.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (fituar)
3. TV Real – KKRT me objekt – konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit nr. 515/1, datë 09.10.2006 të KKRT-së; detyrimi i KKRT-së që të rinovojë licencën e TV Real; marrja e masës së sigurimit për mos-ndërprerjen e transmetimit deri në përfundim të gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5441, datë 10.07.2007 vendosi pranimin pjesërisht të padisë së Shoqërisë “Real TV”, duke anuluar vendimin nr. 515/1, datë 09.10.2006 të KKRT-së dhe duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit për ndërprerjen e transmetimit nga ky subjekt, deri në përfundimin e këtij gjykimi. Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj të datës 07.05.2009

- vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 5441, datë 10.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (humbur)
4. TNSH – KKRT me objekt – anulimin e aktit administrativ, Vendimet nr. 529, datë 13.11.2006 të KKRT-së mbi pavlefshmërisë e licencës së subjektit TNSH, marrja e masës për sigurimin e padisë duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 529, date 13.11.2006 të KKRT-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 5355, datë 27.09.2007 vendosi pranimin e padisë së Shoqërisë “Telenorba Shqiptare” sh.a, duke anuluar vendimin nr. 529, date 13.11.2006, si dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij akti derisa ky vendim gjyqësor të marrë formë të prerë. Kundër vendimit nr. 6355, datë 27.09.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ana e KKRT-së në datën 10.10.2007 është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj të datës 26.05.2009 vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 6355, datë 27.09.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (humbur)
  5. Z. Laidan Dani (TV Info Shkodra) – KKRT me objekt – anulimin e Vendimit nr. 597, datë 01.10. 2007 "Për mosdhënie licence", i KKRT, Tiranë dhe rivendosje në afat. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr. 6845, datë 18.07.2008 u vendos rrëzimi i kërkesë-padisë si e pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi nga ana e palës paditëse është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. 958, datë 16.07.2009 vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 6845, datë 18.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (fituar)
  6. Mira Mushi – KKRT me objekt – Shfuqizimin e vendimit nr. 751, datë 07.11.2008 të KKRT-së, si dhe pagën nga data 11.11.2008. (pushuar)
  7. Media Vizion (Vizion +) – KKRT me objekt – detyrimi i palës së paditur për nxjerrjen e vendimit për përcaktimin e frekuencave të ritransmetimit për televizionin Vizion +. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 21.12.2008, u vendos rrëzimi i kërkesë-padisë si e pabazuar në ligj e në prova.

ANEKSI IV

<p style="text-align: center;"><b>RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>PËR EDICIONET INFORMATIVE</b></p> <p style="text-align: center;">Koha e <b>Plotë</b> për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (<i>koha në %</i>)</p> <p style="text-align: right;">Janar - Dhjetor 2009</p>						
Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		4.27%	2.54%	5.10%		4.88%
KRYEMINISTRI		24.23%	27.51%	15.85%		14.10%
QEVERIA		25.52%	23.16%	15.53%		19.25%
PARLAMENTI		7.64%	4.82%	5.08%		4.25%
<hr/>						
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		11.76%	12.47%	6.64%		5.56%
PARTIA SOCIALISTE (PS)		15.94%	18.79%	37.73%		38.10%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0.21%	0.30%	0.07%		0.37%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)		5.62%	5.45%	6.03%		7.56%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)		0.31%	0.12%	0.05%		0.14%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0.12%	0.06%	0.00%		0.12%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		0.23%	0.45%	0.55%		0.89%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)		0.58%	0.36%	0.40%		0.22%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		0.00%	0.03%	0.00%		0.00%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		0.18%	0.16%	0.84%		0.43%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		1.25%	1.79%	1.58%		1.30%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		0.61%	0.36%	1.11%		1.33%
PARTIA PËR DEMOKRACI DHE UNITET (PDU)		0.36%	0.75%	0.37%		0.18%
<hr/>						
PARTI TË TJERA		1.15%	0.88%	3.07%		1.32%
<hr/>						
SHUMA		100.00%	100.00%	100.00%	0.00%	100.00%

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

PËR EDICIONET INFORMATIVE

Koha **Sinkron** për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (*koha në %*)

Janar - Dhjetor 2009

Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI		2.67%	1.63%	4.31%		6.52%	4.10%
KRYEMINISTRI		21.17%	26.86%	14.98%		22.80%	12.84%
QEVERIA		23.84%	22.15%	13.75%		20.60%	19.68%
PARLAMENTI		3.28%	2.04%	1.92%		2.93%	2.14%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		17.15%	15.84%	8.64%		11.91%	6.24%
PARTIA SOCIALISTE (PS)		18.99%	19.30%	40.31%		26.07%	40.13%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0.26%	0.37%	0.07%		0.49%	0.34%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)		6.91%	6.30%	7.19%		5.69%	8.17%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)		0.35%	0.19%	0.09%		0.06%	0.14%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0.17%	0.09%	0.00%		0.06%	0.15%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		0.24%	0.51%	0.55%		0.27%	0.94%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)		0.74%	0.45%	0.52%		0.10%	0.26%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		0.00%	0.03%	0.00%		0.00%	0.00%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		0.13%	0.21%	0.73%		0.12%	0.38%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		1.49%	1.87%	1.77%		0.97%	1.67%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		0.86%	0.41%	1.57%		0.72%	1.49%
PARTIA PËR DEMOKRACI DHE UNITET (PDU)		0.40%	0.73%	0.37%		0.22%	0.12%
PARTI TË TJERA		1.35%	1.02%	3.25%		0.45%	1.23%
SHUMA		100.00%	100.00%	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%

**RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

**PËR EDICIONET INFORMATIVE**

Koha **Sinkron** për Aktorët Politikë (*koha në %*)

Aktori Politik	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RADIO TIRANA	TOP ALB. RAD.
Bamir Topi	2.67%	1.65%	4.38%		6.71%	4.07%
Sali Berisha	24.91%	31.36%	17.63%		25.49%	14.69%
Jozefina Topalli	4.06%	2.65%	2.29%		3.37%	2.08%
Edi Rama	7.38%	9.60%	19.38%		12.47%	18.49%
Aktorë të Tjerë	60.97%	54.74%	56.33%		51.96%	60.67%
<b>Shuma</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>0.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>

**RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**  
**PËR EDICIONET INFORMATIVE**

Koha e **Plotë** për Temën e Lajmit (*koha në %*)

Janar - Dhjetor 2009

TEMA	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RAD TIRANA	TOP ALB RAD
01.POLITIKA		27.17%	29.18%	25.10%		28.99%	23.17%
02.VEPRIMTARIA E PRESIDENTIT		1.63%	0.70%	0.86%		2.41%	0.67%
03.VEPRIMTARIA E QEVERISË		18.99%	12.08%	5.73%		15.67%	6.17%
04.VEPRIMTARIA E PARLAMENTIT		4.48%	2.36%	1.95%		4.63%	2.18%
05.VEPRIMTARIA E QEVERISË VENDORE		1.16%	1.40%	1.09%		1.11%	1.27%
06.VEPRIMTARIA E DREJTËSISË		1.30%	1.97%	5.27%		2.17%	3.26%
07.SOCIALE		17.53%	11.92%	12.92%		12.56%	14.29%
08.EKONOMI		7.80%	6.27%	5.89%		4.61%	2.97%
09.KRONIKA E ZEZË / RENDI		1.21%	3.98%	4.06%		1.75%	4.48%
10.LAJME NGA KOSOVA / RAJONI		2.24%	5.61%	10.13%		9.87%	11.40%
11.LAJME NDËRKOMBËTARE		2.95%	8.33%	14.32%		10.51%	18.81%
12.ART / KULTURË		5.92%	4.87%	4.51%		2.36%	1.87%
13.SPORT		3.36%	5.03%	5.37%		2.37%	4.76%
14.TË TJERA		4.26%	6.30%	2.80%		0.99%	4.70%
.							
SHUMA		100.00%	100.00%	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%